Gjatë këtyre takimeve KQZ ka adresuar kërkesat specifike për secilën komunë të cilat duhet të plotësohen nga administratat kommunale, duke mos u fokusuar vetëm në ato të kushteve të punës, por të diskutohet edhe për qendrat e votimit në zonat urban, qasjen e personave me nevoja të veçanta në zyrat e ZE KKZ, dhe në qendra të votimit, qasje në internet etj.

Pjesa tjeter e vizitave ne komunat tjera pritet te realizohet gjatë muajit korrik

<i>Ndërlidhja:</i>	1. Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme 08/L-228 Neni 68 Paragrafi 5. 2. Vlerësimi i nevojave për zyre të ZEKKZ në secilën komunë
<i>Treguesit</i>	1.Takime te realizuare 2.Memorandumet e mirekuptimit dhe zbatimi i tyre
<i>Vlerësimi i resurseve:</i>	Pa kosto
<i>Sfidat nëse ka vonesa në realizimin e aktivitetit:</i>	Miratimi i rregulloreve zgjedhore dhe mbajtja e procesit te votimit për apo kundër largimit të Kryetarëve në komunat Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë të Veriut kanë ndikuar që ky aktivitet të mos realizohet në tre mujorin e pare. Realizimi i këtij aktiviteti dot bëhet ne tre mujorin e dytë.
<i>Monitorimi nga përgjegjësi për koordinim dhe raportim - koment:</i>	DOZEIAT

Aktiviteti 20:	Hartimi i planit te KESH-it (pani i zotimeve dhe shpenzimeve)
Statusi:	Realizuar
Zyrtari/ja përgjegjës/e:	ZKF
Periudha e realizimit:	Janar 2024
Tjera:	/

#### Përshkrimi i realizimit të aktivitetit:

Bazuar ne rregulloren 01/2022 për Aplikimin e Fonave dhe Menaxhimin e Rrjedhës se Parasë. Pas njoftimit nga MFPT per fillimin e pergaditjes se planit të KESH-it, KQZ ka pergaditë dhe dorëzuar planin e rrjedhës së parasë në Thesar me daten 12.01.2024, i cili eshte aprovuar me daten 15.01.2024 nga Ministria.

<i>Ndërlidhja:</i>	
<i>Treguesit</i>	1. Plani i KESH-it konform planit te buxhetit dhe planit te prokurimit 2. Plani i zotimeve dhe shpenzimeve i aprovuar ne SIMFK, 3. Njoftmi ne KBF
<i>Vlerësimi i resurseve:</i>	Pa kosto
<i>Sfidat nëse ka vonesa në realizimin e aktivitetit:</i>	Nuk ka
<i>Monitorimi nga përgjegjësi për koordinim dhe raportim - koment:</i>	ZKF

<i>Aktiviteti 25:</i>	Lista e Rreziqeve
<i>Statusi:</i>	Nuk është realizuar Propozhet të shtyhet deri ne tetor 2024
<i>Zyrtari/ja përgjegjës/e:</i>	Grupi Punues
<i>Periudha e realizimit:</i>	Qershori 2024
<i>Tjera:</i>	/

Përshkrimi i realizimit të aktivitetit:

Sekretariati i KQZ aoma nuk e ka pranuar listen e rreziqeve.

<i>Ndërlidhja:</i>	Ligjet Nr. 06/I-021, për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike
<i>Treguesit</i>	1. Dokument i hartuar 2. Njoftim në KQZ
<i>Vlerësimi i resurseve:</i>	Pa kosto
<i>Sfidat nëse ka vonesa në realizimin e aktivitetit:</i>	
<i>Monitorimi nga përgjegjësi për koordinim dhe raportim - koment:</i>	Grupi Punues

<i>Aktiviteti 26:</i>	Plani i integritetit
<i>Statusi:</i>	Realizuar
<i>Zyrtari/ja përgjegjës/e:</i>	Grupi Punues
<i>Periudha e realizimit:</i>	Janar – dhjetor 2024

Tjera:

/

#### Përshkrimi i realizimit të aktivitetit:

Grupi punues i formuar me vendimin e KQZ të datën 02.11.2023, Nr.01/1114/2023, ka marrë vendim për themelimin e grupit punues për Hartimin e Planit të Integritetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në përbërje:

1. znj. Emira Alushi Murati- U.D Drejtor i DCL - koordinator/kryesues;
- 2.znj. Vesa Xharra - Zyrtar Ligjor ZRCKFSP anëtar, dhe
- 3.z.Kreshnik Spahiu - Drejtor i DTI - person përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të Planit të Integritetit.

Grupi punues gjatë përiudhës së hartimit të Planit, ka analizuar dokumentacionin e mbledhur (legislacionin dhe aktet nënligjore të zbatueshme në punën e KQZ; përshkrimet e punës dhe fushëveprimin e çdo njësie në institucion) si dhe çdo proces për vendimmarrje dhe ofrimin e shërbimeve. Mbi bazën e analizës së gjendjes aktuale përcaktohen fushat e rrezikut si dhe identifikimi dhe vlerësimi i rreziqeve. Gjatë kësaj faze gjithashtu u analizuar dhe u finalizuar pyetësori. Pyetësori është dërguar me datë 26.01.2024 tek të gjithë stafi i KQZ-së për plotësim deri me datë 29.01.2024.

Grupi punues pas grumbullimit të materialit dhe pranimit të përgjigjeve, mbajti takimin e radhës, ku shqyrtuan kornizën ligjore (ligjet, rregulloret e KQZ) planet e punës, raportet, kontrollin e brendshëm të auditorit, raportet e vlerësimit nga vëzhguesit e zgjedhjeve, planin strategjik të KQZ-së. Po ashtu, grupi punues i shqyrtoi të gjithë përgjigjet e plotësuara nga stafi i KQZ në pyetësorë, ku dhe nxori pikat të cilat janë paraqitë përmes pyetësorëve.

Pas përpilimit të draft - Planit të Integriteti, grupi punues dorëzoi për shqyrtim dhe miratim në KQZ. Plani i Integriteti, është ëmiratuar në mbledhjen e KQZ më datën 15.02.2024, me numër të vendimit 01/144/2024.

Plani i Integriteti pas miratimit, ju është shpërndar gjithë zyrtarëve të KQZ dhe i njëjtë I është dërguar Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.

Ndërlidhja:	Ligji per Parandalimin e Korrupsionit
Treguesit	1.Planii i Integritetit - hartim dhe miratim - I miratuar në KQZ 2.Vlersimi i zbatimit - 3.Mbikqyrja - Raport
Vlerësimi i resurseve:	Pa kosto

<i>Sfidat nëse ka vonesa në realizimin e aktivitetit:</i>	
<i>Monitorimi nga përgjegjësi për koordinim dhe raportim - koment:</i>	Grupi Punues

Aktiviteti 27:	Përgaditja e kontributit për Raportin e Progresit
Statusi:	Realizuar
Zyrtari/ja përgjegjës/e:	Këshilltari Juridik
Periudha e realizimit:	Janar - dhjetor 2024
Tjera:	/

Përshkrimi i realizimit të aktivitetit:

Sekretariati i KQZ më datën 15.03.2024, ka pranuar nga ZKM pytesorin për përgaditjen e kontributit/inputit të parë për Raportin e KE-së për Kosovën – 2024, për periudhën 15 qershor 2023 – 15 prill 2024.

Sherbimi ligjor, pras pranimit të pyesorit, me daten 20.03.2024 si dhe me daten 25.03.2024, ka derguar pytesorin tek njesite pergjegjese per marrjen e inputit.

Sekretariati i KQZ, më datën 01.04.2024 ka dërguar në ZKM, Përgjigjet në pytësorin për përgaditjen e kontributit/inputit të parë për Raportin e KE-së për Kosovën – 2024.

Ndërlidhja:	ZKM
Treguesit	1.Pytesori I pranuar nga Ministria 2.Pergjigjet nga SKQZ 3.Shqyrtimi ne KOZ 4.Dergimi ne Ministrine pergjegjese
Vlerësimi i resurseve:	Pa kosto
<i>Sfidat nëse ka vonesa në realizimin e aktivitetit:</i>	Nuk ka pasur vonesa
<i>Monitorimi nga përgjegjësi për koordinim dhe raportim - koment:</i>	Njesite pergjegjese Departamentet

Aktiviteti 28:	Asgjesimi i materialeve zgjedhore
Statusi:	Në proces
Zyrtari/ja përgjegjës/e:	Grupi punues
Periudha e realizimit:	Janar - dhjetor 2024
Tjera:	/

### Përshkrimi i realizimit të aktivitetit:

Drejtori i Sekretariatit me daten 16.02.2024, ka marr vendim Nr.02/148/2024, për formimin e komisionit për evidentimin, regjistrimin e lëndëve sipas vendimeve gjyqësorë, për vendvotimet që janë duke u ruajtur në QNR, për hetim nga organet e drejtësisë. Komisioni eshte ne kete përbërje:

1. Emira Alushi Murati, Kryesuese
2. Armir Rexhaj, ZE KKZ në Gjakovë, anëtar
3. Hyrije Dumani, ZE KKZ në Fushë Kosovë, anëtar
4. Artan Mezraja, ZE KKZ në Kaçanik, anëtar
5. Xhavit Gaxherri, ZE KKZ, në Junik, anëtar
6. Shaban Rexha, ZE KKZ në Ferizaj, anëtar
7. Xhemail Peqani, anëtar
8. Prentim Rrustemi, anëtar

Ky vendim ka pasur për qëllim evidentimin e lëndëve dhe më pastaj asgjësimine tyre për të cilat është arritur afati i parashkrimit.

Komisioni ka përfunduar procesin e evidentimit të këtyre lëndëve në databazë.

Gjithashtu, me datën 04.07.2024, , eshte hartuar shkresa per institucionet perkatese, dhe është proceduar te drejtori I SKQZ, lidhur me materialet zgjedhore të zgjedhjeve të lartcekura, janë ruajtura nga KQZ-ja me kërkesën e organeve të drejtësisë për objekt hetimi, të cilat bazuar në legjislacionin në fuqi dhe vitin e mbajtjes së zgjedhjeve, këto lëndë (vendvotime) kanë arritur afatin e parashkrimit absolut dhe të njëjta nuk kanë më efekt juridik për provë në procedurën penale, per zgjedhjet si ne vijim:

1. 1.Zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar komune në Ferizaj, të mbajtura më 29 prill 2012
2. 2.Zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar komune në Ferizaj, Raundi i dytë, të mbajtura më 27 maj 2012
3. 3.Zgjedhjet për Kuvendin Komunal dhe kryetar të komunave, të mbajtura më 03 nëntor 2013
4. 4.Raundi i dytë i zgjedhjeve për kryetar të komunave , të mbajtur më 01 dhjetor 20213
5. 5.Zgjedhjet parakohshme për Kuvendin e Kosovës, të mbajtura më 08 qershor 2014,

Ndërlidhja:	Ligji për zgjedhjet 08/L-228
-------------	------------------------------

<i>Treguesit</i>	1.Identifikimi I lendeve zgjedhore 2.Regjistrimi ne databaze 3.Asgjesimi
<i>Vlerësimi i resurseve:</i>	Me kosto
<i>Sfidat nëse ka vonesa në realizimin e aktivitetit:</i>	
<i>Monitorimi nga përgjegjësi për koordinim dhe raportim - koment:</i>	Njesite perjegjese Departamentet DCL/DAP/DOZ/QNR

<i>Aktiviteti 29:</i>	Punëtori me zyrtarët ekzekutiv të zgjedhjeve per planin e punes dhe planifikim
<i>Statusi:</i>	Realizuar për këtë periudhë
<i>Zyrtari/ja përgjegjës/e:</i>	ZEKKZ Vushtrri
<i>Periudha e realizimit:</i>	Shkurt, nëntor 2024
<i>Tjera:</i>	/

#### Përshkrimi i realizimit të aktivitetit:

Pjesa e parë e këtij aktiviteti e mbështetur nga OSBE, është realizuar më 28.02.2024, ku kanë marrë pjesë anëtaret e KQZ, stafi i SKQZ, ZE KKZ dhe përfaqësuesit e OSBE. Në këtë punëtori janë trajtuar temat: Prezantimi i planit të punës të KQZ, për vitin 2024, dhe planifiikim. Njoftimi lidhur me aktivitetet të cilat dalin nga Plani i punës për ZE KKZ-të, prezantimi i Rregullave Zgjedhore të KQZ-së dhe harmonizimi i tyre me Ligjin nr. 08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosoves (LZP), prezantimi i rregulloreve të Brendshme të KQZ-së, etj.

Agjenda, Projekti dhe temat të cilat janë trajtuar në punëtorin e parë janë shqyrtaar dhe miratuar në mbledhjen e KQZ, nr.01/146-2024, 15.02.2024. Në kuadër të këtij aktiviteti është paraparë të mbahet edhe një punëtori, e cila gjithashtu do të përkrahët nga OSBE, në muajin nëntor 2024.

<i>Ndërlidhja:</i>	PLani Strategjik i KQZ 2023-2026
<i>Treguesit</i>	1. Raportet e punes nga takimet e mbajtura 2. Draft lista e aktivitetetve për te propozuara per vitin 2025
<i>Vlerësimi i resurseve:</i>	Aktiviteti përkrahët nga OSBE
<i>Sfidat nëse ka vonesa në realizimin e aktivitetit:</i>	Nuk ka pasur vonesa
<i>Monitorimi nga përgjegjësi për koordinim dhe raportim - koment:</i>	DOZEIAT

Aktiviteti 30:	Simulimi i procesit zgjedhor
Statusi:	Në proces Propozohet të shtyhet deri ne shtator 2024
Zyrtari/ja përgjegjës/e:	Drejtori i DOZEIAT
Periudha e realizimit:	Shkurt - korrik 2024
Tjera:	/

#### Përshkrimi i realizimit të aktivitetit:

Më datë 12.07.2024 Drejtori i SKQZ-së me vendim ka formuar grupin per hartimin e projektit për simulimin e procesit zgjedhor, grupei është I përber nga 5 anëtar.

#### Qëllimi i Simulimi i procesit zgjedhor

Zhvillimi i këtij projekti synon avancimin e infrastrukturës zgjedhore ne Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ). Duke u bazuar ne ndryshimet ne LZP dhe hartimin e rregulloreve te reja zgjedhore, me mbështetje te OSBE-se është bere ndërtimi i softuerit te ri për procedurat e caktuara zgjedhore, ku rrjedhimisht si domosdoshmëri shtronhet nevoja për testimin e mbarëvajtjes se sistemit te ri i ndërtuar ne module te procedurave përkatëse.

Simulimi i proceseve të ditës së zgjedhjeve dhe prezantimi i Softuerit të Zgjedhjeve: Zhvillimi i një procesi dyditor duke simuluar procese të caktuara të zgjedhjeve duke përfshirë trajnimin, votimin, numërimin, pranim-dorëzimi i materialeve dhe tabelimi i rezultateve në Qendrat Komunale të Numërimit (QKN) si dhe Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) duke përdorur softuerin e zgjedhjeve të zhvilluar rishtazi për të gjeneruar të dhënat e kërkua dhe për të ofruar rezultate të sakta.

Simulimi i procesit zgjedhore planifikohet te mbahet ne muajin gusht.

Ndërlidhja:	LZP/Plani strategjik
Treguesit	<ol style="list-style-type: none"> <li>Projekti per simulimin e procesit zgjedhor - dokument I shqyrta dhe miratuar</li> <li>Raporti me te gjeturat dhe rekomandimet nga simulimi i procesit zgjedhor</li> </ol>
Vlerësimi i resurseve:	Ky aktivitet do të përkrahet nga OSBE (ekspertizë)
Sfidat nëse ka vonesa në realizimin e aktivitetit:	<p>Miratimi i rregulloreve zgjedhore në muajin mars dhe mbajtja e procesit te votimit për apo kundër largimit të Kryetarëve në komunat Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë të Veriut.</p> <p>Ky aktivitet do të realizohet në tre mujorin e dytë.</p>
Monitorimi nga përgjegjësi për koordinim dhe raportim - koment:	DOZEIAT

## 2.2 KORNIZA LIGJORE

Aktiviteti 31:	Miratimi i ndryshim plotësimit të Rregulloreve zgjedhore
Statusi:	Në process - Propozhet të shtyhet deri ne shtator 2024
Zyrtari/ja përgjegjës/e:	Grupi Punues
Periudha e realizimit:	Janar – shkurt 2024
Tjera:	/

### Përshkrimi i realizimit të aktivitetit:

KQZ, nga gjithesejtë shtatëmbëdhjetë (17) Rregullore Zgjedhore, ka miratuar trembëdhjetë (13) prej tyre, ndërsa kanë mbetur pa miratim edhe katër (4) Rregullore zgjedhore, si në vijim rregulloret e miratuara:

1. Rregullore Zgjedhore Nr. 01/2024, Regjistrimi dhe Funksionimi i Partive Politike
2. Rregullore Zgjedhore Nr 02/2024 për Emërimin, Përbërjen dhe Funksionimin e Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve
3. Rregullore Zgjedhore Nr.03/2024 Krijimi, Konfirmimi dhe Kundërshtimi i Listës së Votuesve
4. Rregullore Zgjedhore Nr.04/2024, Certifikimi i Subjekteve Politike dhe i Kandidatëve të Tyre
5. Rregullore Zgjedhore Nr.05/2024 për Themelimin dhe Ndërrimin e Qendrave të Votimit
6. Rregullore Zgjedhore Nr.08/2024 Vëzhguesit e Zgjedhjeve
7. Rregullore Zgjedhore Nr.09/2024 Regjistrimi dhe Votimit i Personave me Nevoja të Veçanta
8. Rregullore Zgjedhore Nr. 10/2024 Fletëvotimet dhe Broshurat
9. Rregullore Zgjedhore Nr. 11/2024 Këshillat e Vendvotimeve
10. Rregullore Zgjedhore Nr.12/2024 Votimi, Numërimi në Vendvotim dhe Menaxhimi i Qendrës së Votimit
11. Rregullore Zgjedhore Nr.13/2024 Rezultatet Zgjedhore
12. Rregullore Zgjedhore Nr.14/2024 Qendra e Numërimit dhe Rezultateve
13. Rregullore Zgjedhore Nr.16/2024, Qendrat Komunale të Numrimit

Rregulloret të cilat ende janë në proces të shqyrimit dhe finalizimit, janë si në vijim:

1. Rregullore Zgjedhore Nr.06/2024 Regjistrimi dhe Votimi Jashtë Kosovës
2. Rregullore Zgjedhore Nr. 07/2024 Fushata e Zgjedhjeve
3. Rregullore Zgjedhore Nr.15/2024 Zgjedhjet e Parakohshme

4. Rregullore Zgjedhore Nr. 17/2024 Zëvendësimi i Anëtarëve të Kuvendeve Komunale

Tabela e bashkangjitur:

Nr.	Emërtimi	Statusi	Miratimi
1	Rregullore Zgjedhore Nr. 01/2024, Regjistrimi dhe Funksionimi i Partive Politike	e shqyrtuar	E miratuar me dt.06.03.2024
2	Rregullore Zgjedhore Nr. 02/2024 për Emërimin, Përbërjen dhe Funksionimin e Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve	e shqyrtuar	E miratuar me dt.06.03.2024
3	Rregullore Zgjedhore Nr. 03/2024 Krijimi, Konfirmimi dhe Kundërshtimi i Listës së Votuesve	e shqyrtuar	E miratuar me dt.06.03.2024
4	Rregullore Zgjedhore Nr.04/2024, Certifikimi i Subjekteve Politike dhe i Kandidatëve të Tyre	e shqyrtuar	E miratuar me dt.06.03.2024
5	Rregullore Zgjedhore Nr. 05/2024 për Themelinin dhe Ndërrimin e Qendrave të Votimit	e shqyrtuar	E miratuar me dt.08.03.2024
6	Rregullore Zgjedhore Nr.06/2024 Regjistrimi dhe Votimi Jashtë Kosovës	Ne proces	
7	Rregullore Zgjedhore Nr.07/2024 Fushata e Zgjedhjeve	Në proces të shqyrtimit	
8	Rregullore Zgjedhore Nr. 08/2024 Vëzhguesit e Zgjedhjeve	e shqyrtuar	E miratuar me dt.08.03.2024
9	Rregullore Zgjedhore Nr.09/2024 Regjistrimi dhe Votimit i Personave me Nevoja të Veçanta	e shqyrtuar	E miratim me dt.28.03.2024
10	Rregullore Zgjedhore Nr. 10/2024 Fletëvotimet dhe Broshurat	e shqyrtuar	E miratuar me dt.08.03.2024
11	Rregullore Zgjedhore Nr. 11/2024 Këshillat e Vendvotimeve	e shqyrtuar	E miratuar me dt.08.03.2024

12	Rregullore Zgjedhore Nr.12/2024 Votimi, Numërimi në Vendvotim dhe Menaxhimi i Qendrës së Votimit	e shqyrtuar	E miratuar me dt.12.03.2024
13	Rregullore Zgjedhore Nr.13/2024 Rezultatet Zgjedhore	e shqyrtuar	E miratuar me dt.12.03.2024
14	Rregullore Zgjedhore Nr.14/2024 Qendra e Numërimit dhe Rezultateve	e shqyrtuar	E miratim me dt.28.03.2024
15	Rregullore Zgjedhore Nr.15/2024 Zgjedhjet e Parakohshme	e shqyrtuar	
16	Rregullore Zgjedhore Nr.16/ 2024, Qendrat Komunale të Numrimit	e shqyrtuar	E miratuar me dt.22.03.2024
17	Rregullore Zgjedhore Nr. 17/2024, për Zëvendësimin e Anëtarëve të Kuvendeve Komunale	Në proces të shqyrtimit	

Ndërlidhja:	LZP 08/L-228
Treguesit	1. Numri i plotësim ndryshimeve të rregulloreve zgjedhore, 2. Draftet e shqyrtuara 3. Draftet e miratuara
Vlerësimi i resurseve:	Pa kosto
Sfidat nëse ka vonesa në realizimin e aktivitetit:	
Monitorimi nga përgjegjësi për koordinim dhe raportim - koment:	Këshilltar Juridik

Aktiviteti 32:	Shqyrtimi dhe miratimi i rregulloreve të ZRCKFSP
Statusi:	Realizuar
Zyrtari/ja përgjegjës/e:	Z.L. për Regjistrim dhe Certifikim dhe Z.L. Ligjor në ZRCKFSP
Periudha e realizimit:	janar – mars 2024
Tjera:	/

#### Përshkrimi i realizimit të aktivitetit:

KQZ, ka miratuar tri (3) rregulloret zgjedhore që kanë të bëjnë me: regjistrimin dhe funksionimin e partive politike, certifikimin e subjekteve politike dhe akreditimin e vëzhguesve në zgjedhje.

- Rregullore Zgjedhore nr. 01/2024 – Regjistrimi dhe Funksionimi i Partive Politike, është miratuar nga KQZ, me datën 06.03.2024;
- Rregullore Zgjedhore nr. 04/2024 - Certifikimi i Subjekteve Politike dhe i Kandidatëve të tyre, është miratuar nga KQZ, me datën 06.03.2024;
- Rregullore Zgjedhore nr. 08/2024 – Vëzhguesit e Zgjedhjeve, , është miratuar nga KQZ, me datën 08.03.2024.

<i>Ndërlidhja:</i>	Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Ligjit për Financimin e Subjekteve Politik
<i>Treguesit</i>	1. Rregulloret e shqyrtuara dhe të miratuara;
<i>Vlerësimi i resurseve:</i>	Pa kosto
<i>Sfidat nëse ka vonesa në realizimin e aktivitetit:</i>	
<i>Monitorimi nga përgjegjësi për koordinim dhe raportim - koment:</i>	Drejtor i ZRCKFSP

Aktiviteti 33:	Miratimi i Rregulloreve të brendshme të KQZ-së
Statusi:	Në proces – aktiviteti propozohet të shtyhet deri ne nëntor 2024
Zyrtari/ja përgjegjës/e:	Drejtor i ZRCKFSP / Drejtor i DCL / Drejtor i DAP
Periudha e realizimit:	janar – shkurt 2024
Tjera:	/

Përshkrimi i realizimit të aktivitetit:

Më 18 janar KQZ, ka miratuar rregulloret e brendshme të KQZ, si në vijim:

1. Rregullore e Brendshme nr. 01/2024 për Pranimin e Nëpunësve civil në KQZ;
2. Rregullore e Brendshme nr. 02/2024 për Pranimin e Personelit të Përkohshëm në KQZ;
3. Rregullore (KQZ) nr. 02/2024 për Pranimin e Personelit të Përkohshëm në KQZ;
4. Rregullore e Brendshme nr. 03/2024 për Procedurat e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil në KQZ;
5. Rregullore e Brendshme nr. 04/2024 për Disiplinën e Zyrtarëve Publik në KQZ;
6. Rregullore e Brendshme nr. 05/2024 për Kodin e Etikës për Zyrtarët Publik në KQZ;
7. Rregullore e Brendshme nr. 06/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Zyrën për Regjistrim, Certifikim dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike (ZRCKFSP);

8. Rregullore e Brendshme nr. 07/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në KQZ;
9. Rregullore e Brendshme nr. 08/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në KQZ;
10. Rregullore e Brendshme nr. 09/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civilë në KQZ;
11. Rregullore e Brendshme nr. 10/2024 për Shtesat dhe Kompensimet në KQZ;
12. Rregullore e Brendshme nr. 11/2024 për Pranimin e Drejtorit të Sekretariatit të KQZ.

Disa draft Rregullore të brendëshme të cilat ende janë në proces të hartimit, shqyrtimit dhe finalizimit, pritet që të shqyrtohen gjatë muajit gusht, shtator dhe tetor 2024 .

<i>Ndërlidhja:</i>	Ligi për Zgjedhjet e Përgjithshme, Ligi për Zyrtarët Pubik
<i>Treguesit</i>	1. Numri i plotësim ndryshimeve të rregullave te brendshme 2. Draftet e shqyrtuara dhe të miratuara
<i>Vlerësimi i resurseve:</i>	Pa kosto
<i>Sfidat nëse ka vonesa në realizimin e aktivitetit:</i>	
<i>Monitorimi nga përgjegjësi për koordinim dhe raportim - koment:</i>	Drejtor i ZRCKFSP / Drejtor i DCL / Drejtor i DAP

## 2.3 GJITHËPËRFSHIRJA DHE PJESËMARRJA NË ZGJEDHJE

Aktiviteti 35:	Procedura të qarta për operacione zgjedhore
Statusi:	Në proces
Zyrtari/ja përgjegjës/e:	DOZ / DTI / DFSHP
Periudha e realizimit:	Janar – dhjetor 2024
Tjera:	/

### Përshkrimi i realizimit të aktivitetit:

Aktiviteti për procedura të qarta për oepracione zgjedhore në tre mujorin e dytë (T2) ka filluar draftimi i procedurave te votimit dhe numërimit në vendvotim.

Në tre mujorin e tret do të organizohet aktiviteti i simulimi i procesit zgjedhor ku pas ketij aktiviteti do te finalizohen te gjitha procedurat zgjedhore.

<i>Ndërlidhja:</i>	Plani Strategjik
--------------------	------------------

Treguesit	1. Analiza e përfunduar për vlerësimin e procedurave zgjedhore. 2. Testimi dhe simulimi paraprak i praktikave të mira për çështje zgjedhore. 3. Procedurat e miratuara.
Vlerësimi i resurseve:	2,000 Euro, Buxhet i KQZ
Sfidat nëse ka vonesa në realizimin e aktivitetit:	Miratimi i rregulloreve zgjedhore në muajin mars dhe mbajtja e procesit te votimit për apo kundër largimit të Kryetarëve në komunat Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë të Veriut. Ky aktivitet do të realizohet në tre mujorin e dytë, tretë.
Monitorimi nga përgjegjësi për koordinim dhe raportim - koment:	DOZEIAT / DFSh{ / DTIZShV

Aktiviteti 36:	Analizë dhe hulumtim i planeve te detajuara për infomim
Statusi:	Në proces aktiviteti propozohet të shtyhet deri ne nëntor 2024
Zyrtari/ja përgjegjës/e:	Ekseprt i Jashtem
Periudha e realizimit:	Janar – mars 2024
Tjera:	/

#### Përshkrimi i realizimit të aktivitetit:

KQZ i ka kérkuar OSBE ODIHR përkrahje në fushën e Infromimit Publik përfshirë edhe përkahjen me një ekspert për analizimin e Informimit Publik. ODIHR ka konfirmuar se do të përkrahë KQZ me një ekspert nga fusha e IP. Aktiviteti ka filluar pas përzgjedhjes se ekspertit nga ana e OSBE/ODHIR, dhe është mbajtur një takim me datën 7 qershor, dhe sipas kérkesës së ekspertit të jashtëm Divizioni i ka dërguar materialet si në vijim, Strategjinë e fundit të Informimit Publik të zgjedhjeve te vitit 2021, Analizën e efektivitetit të Fushatës së IP-së të fundit, si dhe Planin strategjik të KQZ-së dhe Raportin e BE-së.

Eksperti me datën 26 qershor ka dërguar disa komente dhe rekomandime pas trajtimit të këtyre dokumenteve.

Puna ka filluar pasi u përzgjodh eksperti nga OSBE/ODHIR dhe mbajti një takim më 7 qershor. Pas këtij takimi, sipas kérkesës së ekspertit të jashtëm, Divizioni ka dërguar disa materiale, duke përfshirë Strategjinë e fundit të Informimit Publik të zgjedhjeve të vitit 2021, Analizën e efektivitetit të Fushatës së Informimit Publik të fundit, si dhe Planin strategjik të KQZ-së dhe Raportin e BE-së të zgjedhjeve të vitit 2021. Më pas, më 26 qershor, eksperti ka dërguar disa komente dhe rekomandime pas trajtimit të këtyre dokumenteve. Rekomandimet janë përfshirë në Planin për edukim dhe informim për zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës.

<i>Ndërlidhja:</i>	Plani Strategjik 2023 - 2026
<i>Treguesit</i>	Planet e Informimit të hartuara dhe aprovuara
<i>Vlerësimi i resurseve:</i>	Pa kosto
<i>Sfidat nëse ka vonesa në realizimin e aktivitetit:</i>	
<i>Monitorimi nga përgjegjësi për koordinim dhe raportim - koment:</i>	KOZ/KQZ

<i>Aktiviteti 37:</i>	Hartimi dhe miratimi i Strategjisë për Informim Publik për Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës 2024/2025 dhe Zgjedhjet Lokale 2025
<i>Statusi:</i>	<b>Në proces</b>
<i>Zyrtari/ja përgjegjës/e:</i>	Udhëheqësi i Divisionit për Edukim dhe Informim
<i>Periudha e realizimit:</i>	Janar - dhjetor 2024

#### Përshkrimi i realizimit të aktivitetit:

Divizioni për Edukim dhe Informim ka hartuar Planin për edukim dhe informim për Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës në vitin 2025, dhe ka dërguar për shqyrtim, me datë 26 qershori 2024.

Plani bazohet në kërkesat që burojnë nga ligji për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe rregullat zgjedhore.

Plani përfshinë nevojat për edukim dhe informim për të gjithë qytetarët me të drejtë vote, pavarësisht moshës, gjinisë, nevojave të veçanta, vendbanimit dhe nacionalitetit.

Ky plan përfshinë të gjitha aktivitetet për secilën nga fazat e procesit zgjedhor, duke përfshirë edhe bashkëpunimin me institucionet e ndryshme për të dërguar informacionet, mesazhet për procesin zgjedhor te votuesit dhe te palët e interesit, përmes mjeteve të ndryshme të komunikimit, në mënyrë që të arrihet një proces i suksesshëm dhe i pakontestueshëm zgjedhor.

Për hartimin e këtij plani, janë marrë për bazë kërkesat ligjore, përvojat nga proceset e kaluara zgjedhore dhe rekomandimet e dala prej raporteve, analizave, hulumtimeve dhe dokumenteve specifike si derivat nga proceset e ndryshme zgjedhore.

Plani për edukim dhe informim përqendrohet në tri shtylla të rëndësishme:

Informimi i të gjithë qytetarëve të Kosovës për procesin dhe procedurat zgjedhore; Informimi i saktë dhe me kohë i të gjithë votuesve dhe palëve të interesit; dhe

Formulimin e mesazheve të qarta, të thjeshta, të kuptueshme për të gjithë votuesit dhe në gjuhet e tyre.

Plani për edukim dhe informim, pritet të shqyrtohet dhe miratohet nga KOZ-i dhe KQZ.

Për Planin për Edukim dhe Informim për Zgjedhjet Loakle ka mbetur të diskutohet në KOZ, që të mbetet të përgatitet në vitin 2025.

<i>Ndërlidhja:</i>	Plani Strategjik
<i>Treguesit</i>	1. Strategjia e Informimit Publik e hartuar. 2. Strategjia e Informimit Publik e miratuar. 3. Zbatimi i startegjisë. 4. Përgatitja e raportit përbledhës mbi zbatimin e strategjisë së informimit publik
<i>Vlerësimi i resurseve:</i>	30,000 Euro, Buxhet i KQZ
<i>Sfidat nëse ka vonesa në realizimin e aktivitetit:</i>	

Aktiviteti 39:	Informimi dhe Edukimi i Votuesve të Rinjë
<i>Statusi:</i>	Në proces
<i>Zyrtari/ja përgjegjës/e:</i>	Udhëheqësi i Divisionit për Edukim dhe Informim
<i>Periudha e realizimit:</i>	Shkurt - korrik 2024
<i>Tjera:</i>	/

#### Përshkrimi i realizimit të aktivitetit:

Projekti "Informimi dhe Edukimi i Votuesve të Rinj për Zgjedhje", i miratuar në mbledhjen e KQZ-së me datën 6 tetor 2023, me nr. të vendimit 01/1025-2023, u bart për t'u realizuar në vitin 2024 pasi nuk u realizua në vitin e paraparë.

Projekti është shqyrtuar në mbledhjen e KOZ-it, me datë 15.02.2024, ku janë bërë disa plotsim ndryshime dhe ka njofuar KQZ, në mbledhjen nr. 08/2024, me datë 15.02.2024, që dokumeti është i përfunduar dhe ka rekomanduar për të vazhduar tutje me realizimin e tij. Kontrata është nënshkruar me 08.05.2024.

Produktet e planifikuara në këtë projekt janë shqyrtuar dhe miratuar në mbledhjen e KOZ-it nr. 18/2024, me datë 24.04.2024. KQZ, në mbledhjen nr. 29/2024, me datë 29.04.2024, ka miratuar produktet e planifikuar në këtë projekt, me nr. të Vendimi 01/748-2024.

Aktivitete edukuese dhe informuese me të rinj filluan të realizohen nga data 7 maj 2024. Gjatë realizimit të këtij projekti, është mbajtur ligjëratë me temën: Informimi dhe Edukimi i Votuesve të Rinj për Zgjedhje. Ligjëratat janë mbështetur tek koncepti dhe rëndësia e zgjedhjeve, për të drejtën e tyre për të votuar, rëndësinë e votës së tyre, për procesin, sistemin dhe procedurat zgjedhore në vendin tonë, angazhimin dhe përfshirjen e të rinjve në procesin e zgjedhjeve lokale dhe qendrore, pjesëmarrjen e tyre në vëzhgimin e zgjedhjeve, të drejtën për të zgjedhur dhe për të qenë i zgjedhur, caktimi dhe ndërrimi i qendrës së votimit. Po ashtu, gjatë ligjërimit është bërë edhe simulimi i votimit dhe ju shpérndanë fletëpalosje, lapse kimikë, byzylykë dhe stikerës.

Aktivitetet e këtij projekti në komuna janë zhvilluar në bashkëpunim të drejtpërdrejtë me ZEKKZ-të, me drejtorit komunale të arsimit, drejtorët e shkollave të mesme, këshillin rinor të ambasadës Amerikane, këshillat e nxënësve dhe këshillat e veprimeve rinore.

Gjatë sesioneve informuese u realizua edhe Videospoti i cili u publikua në rrjetet sociale të KQZ-së dhe u transmetua në RTK1, RTK2 dhe RTK3. Gjatë aktiviteteve, u realizuan edhe fotografi dhe u publikuan në uebfaqe dhe rrjetet sociale të KQZ-së.

Ky aktivitet (në nivel vendi), është realizuar në 31 komuna.

Projekti, nuk është realizuar në komunat: Zveqan, Leposaviq, Zubin Potok, Mitrovica e Veriut, Partesh, Kllokot dhe Ranillug.

### **Organizimi i aktiviteteve në Universitete**

Në periudhën nga 13 qershor deri më 28 qershor 2024, Komisioni Qendoror i Zgjedhjeve (KQZ), në bashkëpunim me Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina" dhe universitete të tjera në Kosovë, organizoi fushatën informuese dhe edukuese "Zëri yt, vota jote".

Zyrtarët e KQZ-së takuan qindra studentë nga shumë fakultete të Universitetit të Prishtinës si: Fakulteti i Edukimit, Fakulteti Filozofik, Fakulteti i Edukimit Fizik, Sportit, Biblioteka Kombëtare Universitare, Fakulteti i Filologjisë, Fakulteti i Mjekësisë, Fakulteti Juridik, Fakulteti Ekonomik, Fakulteti i Arteve, Fakulteti i Ndërtimitarisë, Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Komjuterike, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, Fakulteti i Arkitekturës, Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore.

Takime u organizuan edhe në Universitetin e Gjakovës "Fehmi Agani", Universitetin e Mitrovicës "Isa Boletini", Universitetin "Kadri Zeka" në Gjilan, Universitetin "Ukshin Hoti" në Prizren, Universitetin e Shkencave të Aplikuara në Ferizaj dhe Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë.

Gjatë këtyre takimeve, studentët u informuan për të drejtat kushtetuese të tyre për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur, si dhe për procesin zgjedhor në vend. Po ashtu, u informuan për mundësitë që ofron KQZ-ja për të ndryshuar qendrën e tyre të votimit në çdo kohë, jo vetëm gjatë periudhave zgjedhore, etj. Studentëve ju shpërndanë fletëpalosje, lapse kimikë, byzylykë dhe stikerës.

Bazuar në qëllimet dhe objektivat e këtij projekti, metodat dhe mënyrat e përdorura për realizimin e tij, arritjet dhe sfidat e hasura, si dhe duke marrë në konsideratë cilësitë, përparësitë, kohën e implementimit, hapësirat dhe faktorët e tjerë që e kanë përcjellur këtë projekt, në përgjithësi, projekti ka arritur të arrijë gjeneratat e caktuara: maturantët, të rinjtë dhe studentët. Mesazhet dhe përbajtjet e tij janë përcjellë me sukses tek kjo audiencë e caktuar.

<i>Ndërlidhja:</i>	Plani Strategjik 2023-2026
<i>Treguesit</i>	<p>1. Realizimi i aktiviteteve në: Sallat e asambleve komunale; Shtëpitë e kulturës; Zyrat e këshillave të veprimeve rimore; Zyrat e qendrave rimore; dhe Shkollat e mesme.</p> <p>2. Numri i pjesëmarrësve në këto aktivitete.</p> <p>3. Përgatitja e raportit përbledhës mbi zbatimin e projektit.</p>
<i>Vlerësimi i resurseve:</i>	20,000 Euro, Buxhet i KQZ
<i>Sfidat nëse ka vonesa në realizimin e aktivitetit:</i>	<p>Vonesat deri te miratimi për të filluar me procedurat e prokurimit.</p> <p>Vonesat deri te nënshkrimi i kontratës.</p> <p>Vonesat deri te miratimi i produkteve.</p> <p>nxëna për procesin e votimit për apo kundër largimit të Kryetarëve në komunat Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë të Veriut</p>
<i>Monitorimi nga përgjegjësi për koordinim dhe raportim - koment:</i>	Udhëheqësi i Divisionit për Edukim dhe Informim

Aktiviteti 40:	Zhvillimi i përbajtjes për Edukim/Informim dhe Trajnimin Digital
Statusi:	Në proces
Zyrtari/ja përgjegjës/e:	DOZEIAT / ZRCKFSP
Periudha e realizimit:	Mars – tetor 2024
Tjera:	/

#### Përshkrimi i realizimit të aktivitetit:

Pas përzgjedhjes se OE nga ana e OSBE-së, Drejtori i SKQZ-së me 23.05.2024. ka themeluar Komisionin për mbikëqyrjen e Platformës për Edukim, informimin e votuesve

dhe trajnim, e cili do të punoj në zhvillimin e platformës. Komisioni se bashku me OE ka zhvilluar disa takime vituale, është zhvilluar dhe testuar sa i përket anës teknike.

Përgatitja e përmbajtjes nga stafi i SKQZ-së duhet të përfundon deri me 2 gusht 2024, për modulet:

1. Edukimi i Votuesve
2. Trajnimi për Administratën e Zgjedhjeve, dhe
3. Moduli i Trajnimit për Vëzhgues.

Zhvillimi i tri moduleve online nga OE do të përfundon deri më 23 gusht 2024, testimi nga stafi i SKQZ-së më 30.08.2024 ndërsa trajnimi i stafit me 06.09.2024.

<i>Ndërlidhja:</i>	Plani Strategjik 2023-2026 / Lzp 08/L-228
<i>Treguesit</i>	<p>Platforma do të përdoret për:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Informimin dhe edukimin e votuesve për të drejtat e tyre.</li> <li>2. Trajnimin e administratës së zgjedhjeve në aspekte të ndryshme të rolit dhe përgjegjësive të tyre në proceset zgjedhore.</li> <li>3. Informimi dhe trajnimi i vëzhguesve të zgjedhjeve</li> </ol>
<i>Vlerësimi i resurseve:</i>	Me kosto / OSBE
<i>Sfidat nëse ka vonesa në realizimin e aktivitetit:</i>	
<i>Monitorimi nga përgjegjësi për koordinim dhe raportim - koment:</i>	Udhëheqësi i Divizionit për Informim

<i>Aktiviteti 41:</i>	Fushatë ndërgjegjësuese për promovimin barazisë gjinore në proceset zgjedhore
<i>Statusi:</i>	<b>Në proces</b>
<i>Zyrtari/ja përgjegjës/e:</i>	DOZEIAT
<i>Periudha e realizimit:</i>	Maj – tetor 2024
<i>Tjera:</i>	/

#### Përvshkrimi i realizimit të aktivitetit:

Ky projekt është në process të përgatitjes. Projekti rekomandohet që të realizohet në muajin tetor 2024. Kjo për shkak të angazhimeve në divisionin për edukim dhe informim, si: Plani për edukim dhe informim për zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës, Platforma për edukim dhe informim, Projekti për votuesit jashtë vendit, Përgatitja e raporteve për projektin votuesit e rinj, komunitet joshumicë, takimet në universitete, Përgatitja e

specifikave për dërgimin e SMS përmes operatorit VALA dhe IPKO, për informiin e votuesve për mundësinë e ndërrimit të qendrës së votimit, etj.

<i>Ndërlidhja:</i>	Plani Strategjik
<i>Treguesit</i>	1. Rritja e pjesëmarrjes së femrave përmes punëtorive të organizuara për zgjedhjet ardhshme. 2. Përgatitja e raportit përbledhës mbi zbatimin e projektit.
<i>Vlerësimi i resurseve:</i>	15,000 Euro, OSBE
<i>Sfidat nëse ka vonesa në realizimin e aktivitetit:</i>	
<i>Monitorimi nga përgjegjësi për koordinim dhe raportim - koment:</i>	Udhëheqësi i Divisionit për Informim

<i>Aktiviteti 42:</i>	Shqyrtimi i planeve orientuese operacionale te zgjedhjeve te rregullta
<i>Statusi:</i>	Realizuar
<i>Zyrtari/ja përgjegjës/e:</i>	SKQZ
<i>Periudha e realizimit:</i>	Mars – qershori 2024
<i>Tjera:</i>	/

#### Përshkrimi i realizimit të aktivitetit:

Në termujorin e parë është hartuar draftplani operacional i zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës bazuar në ligjin per zgjedhjet e per gjithshme. Per arsyet e organizimit të procesit të votimit për ako kundër largimit të kryetarëve të komunave që do të organizohet më 21 prill 2024, ky draftplan nuk është shqyrtuar ne KOZ.

<i>Ndërlidhja:</i>	Plani Strategjik 2023 - 2026
<i>Treguesit</i>	Planet e detajuara te aktivitetev ligjore dhe operacionale per se cilin lloj te zgjedhjeve
<i>Vlerësimi i resurseve:</i>	Pa kosto
<i>Sfidat nëse ka vonesa në realizimin e aktivitetit:</i>	
<i>Monitorimi nga përgjegjësi për koordinim dhe raportim - koment:</i>	KOZ / KQZ

<i>Aktiviteti 43:</i>	Permiresimi dhe përditësimi i listës së votuesve
<i>Statusi:</i>	Në proces
<i>Zyrtari/ja përgjegjës/e:</i>	Divizioni i Sërbinit Votues

Periudha e realizimit:	Janar - korrik 2024
Tjera:	/

#### Përshkrimi i realizimit të aktivitetit:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në muajin janar ka bërë kérkesë në Agjencinë e Regjistrat Civil për pajisjen me ekstraktin e Regjistrat Qendror Civil, në të cilin ekstrakt është kérkuar të përfshihen të gjithë shtetasit, mbi 18 vjeç duke përfshirë edhe ata që mbushin 18 vjeç deri me datën 30.06.2024. Pas pranimit të ekstraktit është bërë alokimi i votuesve në qendrat e votimit dhe publikimi i listës në platformën elektronike për ndërrim të qendrës së votimit.

Gjatë periudhës 01.01.2024 deri 30.06.2024, shërbimi votues ka pranuar kérkesa për ndërrim të QV përmes platformës elektronike dhe përmes zyrave të Komisioneve Komunale Zgjedhore.

Përmes platformës elektronike janë pranuar gjithsej 489 kérkesa për ndërrim të QV, prej tyre 452 kérkesa janë aprovuar ndërsa 37 kérkesa janë refuzuar për arsy se nuk kanë bashkangjitur dokumentet e kérkuara (dokumentin identifikues dhe fotografin e aplikuesit me dokument në dorë). Të gjithë aplikuesit të cilët kanë bërë kérkesë për ndërrim të Qendrës së Votimit përmes platformës elektronike janë njofuar për statusin e kérkesës.

Shërbimi votues gjatë kësaj periudhe nga zyrtarët komunal zgjedhor ka pranuar 110 kérkesa për ndërrimin e qendrës së votimit. Të gjitha kérkesat janë procesuar dhe janë bërë përditësimet në makinën kérkuese.

Raporti statistikor është prezantuar në mbledhjen nr.28, të Këshillit për Operacione Zgjedhore, të mbajtur me datë 21.07.2024.

Në muajin qershor Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka bërë kérkesë në Agjencinë e Regjistrat Civil për pajisjen me ekstraktin e Regjistrat Qendror Civil, në të cilin ekstrakt është kérkuar të përfshihen të gjithë shtetasit, mbi 18 vjeç duke përfshirë edhe ata që mbushin 18 vjeç deri me datën 31.12.2024. Pas pranimit të ekstraktit është bërë alokimi i votuesve në qendrat e votimit dhe publikimi i listës në platformën elektronike për ndërrim të qendrës së votimit.

Ndërlidhja:	Plani Strategjik 2023 - 2026
Treguesit	<ol style="list-style-type: none"> <li>Përqindja e votuesve të caktuar në QV bazuar në adresë.</li> <li>Numri i votuesve të caktuar në bazë të sistemit të adresave që kérkojnë ndërrim e qendrës së votimit.</li> </ol>
Vlerësimi i resurseve:	Pa kosto

<i>Sfidat nese ka vonesa ne realizimin e aktivitetit:</i>	
<i>Monitorimi nga perqjegjesi per koordinim dhe raportim - koment:</i>	Udhëheqesi i Divisionit per Sherbim Votues

Aktiviteti 44:	Identifikimi dhe Vleresimi i Qendrave te Votimit Jashtë Vendit
Statusi:	Në proces
Zyrtari/ja perqjegjes/e:	DOZEIT / DTIZShV
Periudha e realizimit:	Shkurt - nëntor 2024
Tjera:	/

#### Përkthimi i realizimit të aktivitetit:

Rregullorja për votimit jashtë Kosovës është në draftim dhe akoma nuk është miratuar. Gjatë muajit maj dhe qershori Sekretariati ka mbajtur takime me zyrtarët e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe është në proces për definimin e disa çështjeve që lidhen me procesin e votimit në përfaqësi diplomatike dhe votimin përmes postës. Gjithashtu janë kërkuar nga MPJD informata rreth hapësirave të misioneve diplomatike dhe inventarit që posedojnë. Pas definimit të këtyre çështjeve dhe miratimit të rregullores, do të bëhet identifikimi dhe vleresimi i qendrave të votimit jashtë Kosovës.

<i>Ndërlidhja:</i>	Plani Strategjik 2023 – 2026 / LZP 08/L-228
<i>Treguesit</i>	1. Hyrja ne fuqi e Rregullorve të KQZ-se sipas risive të LZP-së, 2. Themeilimi i numrit te QV-ve dhe votimi jashte vendit, ndjekja e praktikave te mira per administrim dhe menaxhim te procesit zgjedhor, ne raport me zbatimin e procedurave te LZP-së.
<i>Vleresimi i resurseve:</i>	10,000 Euro, KQZ
<i>Sfidat nese ka vonesa ne realizimin e aktivitetit:</i>	
<i>Monitorimi nga perqjegjesi per koordinim dhe raportim - koment:</i>	Zyrtaret Ekzekutiv të KKZ-së dhe Udhëheqesi i Divisionit per Sherbim Votues

Aktiviteti 45:	Analizë e Qendrave të Votimit brenda Vendit
Statusi:	Në proces aktiviteti propozohet të shtyhet deri ne shtator 2024
Zyrtari/ja perqjegjes/e:	DOZEIAT / DTIZ
Periudha e realizimit:	Shkurt - prill 2024

Tjera:

/

#### Përshkrimi i realizimit të aktivitetit:

DOZEIAT dhe DTISHVZ janë në process te analizes se qendrave te votimit me ZEKZ-të në teren lidhur me lokacionet e shkollave qe nuk janë qendra te votimit. Aktivitetei prite te finalizohet në muajin tetor.

<i>Ndërlidhja:</i>	Plani Strategjik 2023-2026 / Lzp 08/L-228
<i>Treguesit</i>	1. Hyrja ne fuqi e Rregullorve të KQZ-se sipas risive të LZP-së, 2. Votimi brenda vendit, ndjekja e praktikave te mira per administrim dhe menaxhim te procesit zgjedhor, ne raport me zbatimin e procedurave te LZP-së.
<i>Vlerësimi i resurseve:</i>	Pa kosto, ZEKZ bëjnë analizimin e QV.
<i>Sfidat nëse ka vonesa në realizimin e aktivitetit:</i>	Mbajtja e procesit te votimit për apo kundër largimit të Kryetarëve në komunat Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë të Veriut
<i>Monitorimi nga përgjegjësi për koordinim dhe raportim - koment:</i>	Zyrtaret Ekzekutiv të KKZ-së dhe Udhëheqësi I Divisionit për Sherbim Votues

<i>Aktiviteti 46:</i>	Fushatë senzibilizuese për pjesmarrje në zgjedhje të komuniteteve joshumicë
<i>Statusi:</i>	<b>Në proces</b>
<i>Zyrtari/ja përgjegjës/e:</i>	Udhëheqësi i Divisionit për Informim dhe Edukim të Votuesve
<i>Periudha e realizimit:</i>	Shkurt - shtator 2024
<i>Tjera:</i>	/

#### Përshkrimi i realizimit të aktivitetit:

Sipas planit për realizimin e aktiviteteve me komunitete jo shumicë, në kuadër të fushatës informuese "Zëri yt, vota jote", Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka organizuar aktivitetet informuese dhe edukuese me qytetarët e komuniteteve joshumicë të grup moshave të ndryshme, në regjione të ndryshme të Kosovës. Aktivitetet me komunitetet joshumicë janë mbajtur gjatë muajit qershor në komunat: Fushë Kosovë, Obiliq, Lipjan, Prizren, Gjakovë dhe Graçanicë.

Qëllimi i këtij projekti ishte të informojë dhe të përfshijë më shumë komunitetin joshumicë në proceset zgjedhore në vend. Ata u njoftuan për të drejtën e tyre për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur, procesin dhe procedurat zgjedhore në vendin tonë, rëndësinë e votës, ndikimin që mund të ketë vota e tyre në përcaktimin e përzgjedhjes së

përfaqësuesve të tyre, vendet e garantuara, dokumentet me të cilat votohet dhe mundësin e ndërrimit të qendrës së votimit në çdo kohë.

Gjithashtu, u realizua edhe simulimi i votimit për zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës. Pjesëmarrësit që u janë përgjigjur këtyre takimeve, kanë treguar interesim për temat e prezantuara.

Pjesëmarrësve ju shpërndanë fletëpalosje, lapsë kimik, bylyzykë dhe stikerësa.

Projekti është realizuar në bashkëpunim me Institucionet/OSHC-të partnere për organizimin e aktiviteteve: The Ideas Partnership, Zyra për Komunitete dhe Kthim brenda komunës, Qendra Kulturore Rome në Prizren dhe Learning Center Netëork Gracanicë.

Aktivitetet me komunitetet jo shumicë janë organizuar edhe në komunat: Pejë, Istog dhe Ferizaj. Prezenca e ZEKZ-ve ishte ne vendin dhe kohën e duhur por nuk kishte prezencë të komuniteteve joshumicë, sipas raporteve të ZEKZ-ve ka qenë e pamundur mobilizimi i tyre për pjesëmarrje në këto aktivitete.

<i>Ndërlidhja:</i>	Plani Strategjik 2023-2026
<i>Treguesit</i>	1. Numri i aktiviteteve të realizuara me grupet e synuara. 2. Numri i pjesëmarrësve në këto aktivitete. 3. Rritja e pjesëmarrjes se komuniteteve joshumicë në krahasim me zgjedhjet paraprake.
<i>Vlerësimi i resurseve:</i>	Me kosto, Buxheti i KQZ
<i>Sfidat nëse ka vonesa në realizimin e aktivitetit:</i>	Ky aktivitet nuk është filluar për shkak të angazhimeve të tjera në aktivitet e planikuara në planin e punës së KQZ-së, nr. 37, 39 dhe aktivitetet për procesin e votimit për apo kundër krytarëve në komunat: Mitrovicë e Veriut, Zveçn, Zubin Potok dhe Leposaviq që është organizuar më 21 prill 2024.
<i>Monitorimi nga përgjegjësi për koordinim dhe raportim - koment:</i>	Udhëheqësi i Divisionit për Informim

<i>Aktiviteti 47:</i>	Organizimi i takimeve informuese me akteret zgjedhor
<i>Statusi:</i>	Në proces aktiviteti propozohet të shtyhet deri ne shtator 2024
<i>Zyrtari/ja përgjegjës/e:</i>	DOZEIAT
<i>Periudha e realizimit:</i>	Shkurt - qershor 2024
<i>Tjera:</i>	/

Përshkrimi i realizimit të aktivitetit:

Gjatë tre mujorit të dytë të viti 2024, zedhensi i KQZ-së ka pergaditur pesë video-spote informuese për aspekte të ndryshme të procesit të ardhshëm zgjedhor bazuar në ligjin per zgjedhjet e per gjithshme dhe rregulloret zgjedhore.

<i>Ndërlidhja:</i>	Plani Strategjik 2023 – 2026 / LZP 08/L-228
<i>Treguesit</i>	Raportet me konkluzionet e punetive te dalura
<i>Vlerësimi i resurseve:</i>	Me kosto / Donatorë
<i>Sfidat nëse ka vonesa në realizimin e aktivitetit:</i>	Ky aktivitet nuk është filluar për shkak të procesit te votimit për apo kundër largimit të Kryetarëve në komunat Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë të Veriut.
<i>Monitorimi nga përgjegjësi për koordinim dhe raportim - koment:</i>	DOZEIAT

<i>Aktiviteti 48:</i>	Analizë gjinore dhe e moshës për vëzhguesit e subjekteve politike të certifikuara për Zgjedhjet për Kuvendit të Kosovës dhe Lokale, të vitit 2021
<i>Statusi:</i>	Realizuar
<i>Zyrtari/ja përgjegjës/e:</i>	Drejtori i ZRCKFSP dhe Z.L. Ligjor në ZRCKFSP
<i>Periudha e realizimit:</i>	janar – mars 2024

#### Përshkrimi i realizimit të aktivitetit:

Analizë gjinore dhe e moshës për vëzhguesit e subjekteve politike të certifikuara për Zgjedhjet për Kuvendit të Kosovës dhe Lokale, të vitit 2021, është shqyrtuar dhe miratuar nga Këshilli për Operacione Zgjedhore, në mbledhjen numër 3/ 2024, me datën 06.02.2024. KQZ, në mbledhjen me numër 15/ 2024, e mbajtur me datën 15.03.2024, kishte shqyrtuar dhe miratuar raportin “e mbajtur me datën “Analizë gjinore dhe e moshës për vëzhguesit e subjekteve politike të certifikuara për Zgjedhjet për Kuvendit të Kosovës dhe Lokale, të vitit 2021”.

<i>Ndërlidhja:</i>	
<i>Treguesit</i>	1. Raporti i hartuar; 2. Raporti i shqyrtuar dhe miratuar nga KOZ dhe KQZ.
<i>Vlerësimi i resurseve:</i>	Pa kosto, UNDP
<i>Sfidat nëse ka vonesa në realizimin e aktivitetit:</i>	
<i>Monitorimi nga përgjegjësi për koordinim dhe raportim - koment:</i>	Drejtori i ZRCKFSP, Z.L. Ligjor në ZRCKFSP

## 2.4 INOVACIONI DHE TEKNOLOGJIA

Aktiviteti 49:	Finalizimi i softuerit të integruar të KQZ-së
Statusi:	Në proces
Zyrtari/ja përgjegjës/e:	DTIZShV / ZRCKFSP / DOZEIAT / DFAP
Periudha e realizimit:	Janar - dhjetor 2024
Tjera:	/

### Përshkrimi i realizimit të aktivitetit:

Gjatë kësaj periudhe ka vazduar zhvillimi i moduleve të softuerit. Bazuar ne vendimin e KQZ-se 1029/2022 për themelimin e ekipoit mbikëqyrës për softuerin e KQZ-së, i plotësuar dhe ndryshuar me vendimin 01-217-23, ekipi mbikëqyrësme datë 28.03.2024 ka paraqitur në KQZ informatë lidhur me zhvillimin e softuerit dhe statusit aktual të rregullimeve të nevojshme për modujet aktuale.

Janë zhvilluar funksionet kryesore të softuerit sipas specifikimeve të përcaktuara në dokumentacionin e projektit, përkatësisht modujet: e administrimit të përgjithshëm, menaxhimit të listës së votuese, pasrive dhe subjekteve politike, akreditimit të vëzhguesve, trupave zgjedhore, ndërsa kanë mbetur të finalizohen edhe modujet për rezultatet preliminare dhe përfundimtare.

Pas përfundimit të pjesës së zhvillimit, janë bërë demonstrimet, gjatë të cilave është dëshmuar që në përgjithësi softueri funksionon siç është parashikuar. Gjithashtu, janë identifikuar disa kërkesa dhe gabime që duhet të rregullohen për të përmirësuar funksionimin e moduleve aktuale.

Ekipi do të fokusohet në mbikëqyrjen për adresimin e çdo gabimi dhe kërkesë të identifikuar për të siguruar që softueri të jetë në gjendje të plotësuar e kërkesat e përdoruesve dhe të ofrojë performancë të qëndrueshme.

Gjithashtu, janë identifikuar disa kërkesa dhe gabime që duhet të rregullohen për të përmirësuar funksionimin e moduleve aktuale dhe të cilat janë:

1. Shtimi i raporteve për secilin modul
2. Zhvillimi i API të funksioneve që shërbejnë për aplikim, me qëllim të integrimit në Platformën E-Kosova.
3. Zhvillimin dhe përmirësimin e interfejsave për modujet.
4. Çfarëdo kërkesë që kufizohet në modujet aktuale të softuerit bazuar në procedurat e aprovuara dhe standarde për qasshmëri dhe përdorshmëri.
5. Përgatitja e manualeve dhe trajnimi i përdoruesve për administrim dhe përdorim.
6. Testime shtesë për të konfirmuar funksionimin e plotë.
7. Dorëzimin e kodit burimor.
8. Dorëzimin e dokumentimit të sistemit.

9. Çfarëdo kërkeze që kufizohet në modulet aktuale të softuerit bazuar në procedurat e aprovuara dhe standartet për qasshmëri dhe përdorshmëri.

Ekipi mbikëqyrës, në të njëjtën ditë ka dhënë konkluzionin për OSCE në lidhje me statusin e zhvillimit, duke vlerësuar se përgjithësisht ka përfunduar zhvillimi i 7 moduleve të softuerit dhe pret që të adresohen pikat e sipërpërmendura dhe kërkeshat që identifikohen gjatë mirëmbajtjes, në mënyrë që softueri të jetë funksional sipas specifikave dhe kontratës. Në këtë periudhë janë duke u zhvilluar modulet për rezultatet preliminare dhe përfundimtare pas të cilave do të bëhet testimi dhe simulimi i procesit të zgjedhjeve.

<i>Ndërlidhja:</i>	Plani Strategjik i KQZ-së 2023-2026 ( A47, A48,A53, A54, A.56 )
<i>Treguesit</i>	1. Softueri i zhvilluar, testuar dhe i vënë në funksion 2. Së paku 2 (dy) seanca të trajnimit të mbajtura dhe i gjithë stafi që do të përdor sistemin i trajnuar për perdonimin e softuerit
<i>Vlerësimi i resurseve:</i>	Pa kosto, Donator OSBE
<i>Sfidat nëse ka vonesa në realizimin e aktivitetit:</i>	
<i>Monitorimi nga përgjegjësi për koordinim dhe raportim - koment:</i>	DTIZShV

<i>Aktiviteti 50:</i>	Zbatimi i projektit për teknologji të numërimit në zgjedhje
<i>Statusi:</i>	<b>Në proces</b>
<i>Zyrtari/ja përgjegjës/e:</i>	DTIZShV / DOZEIAT / DFSHP / Prokurimi
<i>Periudha e realizimit:</i>	Shkurt - dhjetor 2024
<i>Tjera:</i>	/

#### Përshkrimi i realizimit të aktivitetit:

Me qëllim të zbatimit të këtij aktiviteti, është kërkuar përkrahja profesionale nga International IDEA ku të njëtin kanë shprehë gatishmërinë që të ndihmojnë me ekspertizë profesionale në hartimin e projektit. Në këtë drejtim eksperti i International IDEA ka rekomanduar që të shikohen projektet e ngjashme të realizuar në shtetin e Letonisë dhe Norvegjisë. Me date 22.03.2024 është mbajtë takimi online me KQZ-në e shtetit të Latvisë, ku është prezantuar projekti dhe janë dhënë sqarimet bazuar në pyetjet dhe çështjet e ngritura nga ne paraprakisht. Sipas planit të dakorduar me ekspertët e IDEA do të mbahet edhe takimi me Drejtorinë për Zgjedhje në Shtetin e Norvegjisë pastaj do të vazhdohet me përgatitjen e projektit.

<i>Ndërlidhja:</i>	LZP, nenit 101, paragrafi 17; Plani Strategjik i KQZ-së 2023-2026 ( A55 )
<i>Treguesit</i>	1. Projekti i detajuar i hartuar dhe aprovuar. 2. Termat e referencës të aprovuar 3. Projekti i implementuar dhe së paku dy simulime të mbajtura
<i>Vlerësimi i resurseve:</i>	720,000 Euro, KQZ
<i>Sfidat nëse ka vonesa në realizimin e aktivitetit:</i>	
<i>Monitorimi nga përgjegjësi për koordinim dhe raportim - koment:</i>	Drejtori i DTIZShV

<i>Aktiviteti 51:</i>	Rishikimi i të gjithë formave zgjedhor dhe ridizajnimi i formave të identikuara gjatë rishikimit
<i>Statusi:</i>	Në proces aktiviteti propozohet të shtyhet deri ne shtator 2024
<i>Zyrtari/ja përgjegjës/e:</i>	DOZEIT / DTIZShV
<i>Periudha e realizimit:</i>	Janar – qershori 2024
<i>Tjera:</i>	/

#### Përshkrimi i realizimit të aktivitetit:

Rregulloret zgjedhore akoma nuk janë miratuar dhe pasi të finalizohen të gjitha Rregulloret do të kompletohen të gjitha aktivitetet zgjedhore për të cilat nevojiten format zgjedhore. Deri me tani janë draftuar format zgjedhore të cilat nderlidhen me rregulloret zgjedhore.

<i>Ndërlidhja:</i>	Plani Strategjik i KQZ-së 2023-2026 ( A.60, A61, A62 )
<i>Treguesit</i>	1. Raporti me rekomandimet nga rishikimi i formave 2. Numri i formave që duhet të ridizajnohen 3. Rezultati nga testimi i kuptimit dhe lehtësisë së plotësimit të formave të ridizajnuara nga procesi i simulimit
<i>Vlerësimi i resurseve:</i>	Pa kosto
<i>Sfidat nëse ka vonesa në realizimin e aktivitetit:</i>	Vonesa ka shkaktuar mos miratimi i te gjitha Rregulloreve Zgjedhore
<i>Monitorimi nga përgjegjësi për koordinim dhe raportim - koment:</i>	Njësia përgjegjëse për procedura/trajnim

Aktiviteti 52:	Zbatimi i Projektit për transparencë në Qendra Komunale të Numërimit
Statusi:	Në proces
Zyrtari/ja përgjegjës/e:	DTIZShV / DOZEIAT
Periudha e realizimit:	Mars - dhjetor 2024
Tjera:	/

Përshkrimi i realizimit të aktivitetit:

Komunikimi me KQZ e Shqipërisë.

Ndërlidhja:	LZP 08/L-228, nenit 101, parografi 17.
Treguesit	1. Projekti i detajuar i hartuar dhe aprovuar. 2. Termat e referencës të aprovuar
Vlerësimi i resurseve:	504,000 Euro, KQZ
Sfidat nëse ka vonesa në realizimin e aktivitetit:	
Monitorimi nga përgjegjësi për koordinim dhe raportim - koment:	Drejtori i DTIZShV

Aktiviteti 53:	Zbatimi i Projektit për vendosjen e kamerave vëzhguese në vendvotime
Statusi:	Në proces
Zyrtari/ja përgjegjës/e:	DTIZShV / DOZEIAT
Periudha e realizimit:	Mars - dhjetor 2024
Tjera:	/

Përshkrimi i realizimit të aktivitetit:

Përmes këtij aktiviteti KQZ ka për qëllim furnizimin me kamera dhe pajisje përcjellëse për regjistrimin e të gjithë aktivitetet në vendvotim në Kosovë, në ditën e zgjedhjeve gjatë procesit të votimit dhe numërimit. Me qëllim të realizimit të këtij aktiviteti njësia përgjegjëse ka ndërrmarrë disa veprime. Fillimisht është vendosur komunikimi me stafin profesional të KQZ-së së Republikës së Shqipërisë ku janë pranuar informatat lidhur me zbatimin e projektit për regjistrimin e kamerave në vendvotime. Më tej është mbajte një takim informues në lidhje me projektin për kamera në KQZ-në e Shqipërisë ku janë marrë informacionet e detajuara në lidhje me përvojën e Shqipërisë në zbatimin e këtij projekti. Është përgatitur projekti i detajuar i cili është shqyrtuar dhe aprovuar në mbledhjen e KOZ-it dhe më pas është aprovuar në mbledhjen e KQZ-së. Me datë 31.05.2024 janë dërguar dokumentet e nevojshme për inicimin e aktivitetit për prokurim. Me qëllim të informimit dhe sqarimit të projektit është mbajte takimi paraofertues me datë 07.06.2024, ku kanë marrë pjesë përfaqësuesit e 4 kompanive të interesuara.

<i>Ndërlidhja:</i>	Vendim i KQZ-së nr. 1074-01-2023 i datës 23.10.2023
<i>Treguesit</i>	1. Projekti i detajuar i hartuar dhe aprovuar 2. Termat e referencës të aprovuar 3. Kontrata e nënshkruar dhe pajisjet e liferuara
<i>Vlerësimi i resurseve:</i>	1,000,000 Euro, KQZ
<i>Sfidat nëse ka vonesa në realizimin e aktivitetit:</i>	
<i>Monitorimi nga përgjegjësi për koordinim dhe raportim - koment:</i>	Drejtori i DTIZShV

<i>Aktiviteti 54:</i>	Dizajnimi i ueb faqes së KQZ për informatat që kanë të bëjnë me regjistrimin dhe certifikimin e subjekteve politike dhe raportimin financiar
<i>Statusi:</i>	Në proces Zbatimi i këtij aktiviteti duhet të zhvendoset në periudhën kohore gusht – tetor 2024 (Tre mujorin e III dhe të IV).
<i>Zyrtari/ja përgjegjës/e:</i>	Drejtori i ZRCKFSP
<i>Periudha e realizimit:</i>	Janar – prill 2024
<i>Tjera:</i>	/

#### Përshkrimi i realizimit të aktivitetit:

Procedurat tenderuese të zhvilluara nga UNDP, kanë përfunduar në muajin qershor të vitit 2024.

**Rekomandimi:** Zbatimi i këtij aktiviteti duhet të zhvendoset në periudhën kohore gusht – tetor 2024 (Tre mujorin e III dhe të IV).

<i>Ndërlidhja:</i>	Plani Strategjik 2023 - 2026
<i>Treguesit</i>	1. Kërkesat për dizajnim; 2. Publikimi i informatave.
<i>Vlerësimi i resurseve:</i>	Pa kosto, UNDP
<i>Sfidat nëse ka vonesa në realizimin e aktivitetit:</i>	
<i>Monitorimi nga përgjegjësi për koordinim dhe raportim - koment:</i>	Drejtori i ZRCKFSP

Aktiviteti 55:	Softueri per menaxhimin e buxhetit dhe financave
Statusi:	Në proces
Zyrtari/ja përgjegjës/e:	DFShP / DTIZShV
Periudha e realizimit:	Janar - qershori 2024
Tjera:	/

#### Përshkrimi i realizimit të aktivitetit:

Draft projekti është dorëzuar dhe i njëjti është vendos ne planin e buxhetit për vitin 2025 për te cilin presim përgjigjen nga MFPT. Ne këtë vit nuk ka mjete buxhetore ne kategorinë e kapitaleve për softuerin ne fjale. Ne rast qe do te ketë ndryshim ne ligjin për buxhet te vitit 2024, për te njëjtin projekt do te bëjmë planifikim ne ndryshimet e buxhetit te këtij viti.

Ndërlidhja:	Ligji per Menaxhimin e Financave Publike dhe Pergjegjesit
Treguesit	1. Projekti i detajuar i hartuar dhe aprovuar 2. Kontrata e nënshkruar dhe zhvillimi i projektit
Vlerësimi i resurseve:	20,000 Euro, Donator
Sfidat nëse ka vonesa në realizimin e aktivitetit:	
Monitorimi nga përgjegjësi për koordinim dhe raportim - koment:	Drejtori i DFShP

## 2.5 BASHKËPUNIMI DHE TRANSPARENCA

Aktiviteti 56:	Rregullorja për mbikëqyrjen vjetore financiare të partive politike dhe mbikëqyrjen financiare të fushatës së zgjedhjeve
Statusi:	Në proces Zbatimi i këtij aktiviteti duhet të zgjatet për periudhën kohorë deri në gusht të vitit 2024 (Tre mujori III).
Zyrtari/ja përgjegjës/e:	Drejtori i ZRCKFSP/ Z.L. për Parti Politike dhe Z.L. Ligjor në ZRCKFSP
Periudha e realizimit:	janar - mars 2024
Tjera:	/

### Përshkrimi i realizimit të aktivitetit:

Rregullorja për mbikëqyrjen financiare të subjekteve politike për raportimin vjetor është miratuar nga KQZ, me datën 21 qershori 2024. Ndërsa, rregullorja për financimin e fushatës së zgjedhjeve është në proces të shqyrtimit.

**Rekomandimi:** Zbatimi i këtij aktiviteti duhet të zgjatet për periudhën kohorë deri në gusht të vitit 2024 (Tre mujori III).

Ndërlidhja:	Ligji për Financimin e Subjekteve Politik
Treguesit	1. Rregulloret e shqyrtuara dhe të miratuara; 2. Pas hyrjes në fuqi të rregulloreve, ZRCKFSP do t'i hartoj procedurat operuese për secilën fushë, të cilat do të shqyrtohen dhe miratoohen nga KQZ
Vlerësimi i resurseve:	Pa kosto
Sfidat nëse ka vonesa në realizimin e aktivitetit:	
Monitorimi nga përgjegjësi për koordinim dhe raportim - koment:	Drejtori i ZRCKFSP, Z.L. për Parti Politike dhe Z.L. Ligjor në ZRCKFSP

Aktiviteti 57:	Zhvillimi i programit të trajnimeve për raportimin financiar të partive politike
Statusi:	Realizuar
Zyrtari/ja përgjegjës/e:	Drejtori i ZRCKFSP/ Z.L. për Parti Politike dhe Z.L. Ligjor në ZRCKFSP
Periudha e realizimit:	shkurt 2024
Tjera:	/

### Përshkrimi i realizimit të aktivitetit:

Me qëllim të përmbushjes së këtij aktiviteti, Zyra ka përgaditur termat e referencës për përzgjdhjen e operatorit ekonomik me qëllim të mbajtjes së trajnimit. Pas përzgjedhjes së operatorit, ZRCKFSP me datën 16.02.2024 ka organizuar trajnimin me përfaqësuesit financiar të partive politike të regjistruara. Trajnimi është mbajtur në sallën e mbledhjeve të KQZ. Në këtë trajnim kanë marrë pjesë përfaqësuesit financiar të dy mbëdhjetë (13) partive politike të regjistruara: KOALICIJA VAKAT, PARTIA DEMOKRATIKE E DIJASPORËS, SRPSKA LISTA, PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS, INICIATIVA BALLI, PARTIA DEMOKRATIKE E UNITETIT, LIDHJA DEMOKRATIKE E KOSOVËS, ALEANCA KOSOVA E RE, PARTIA GUXO, YENILIKCI HAREKET TURK PARTISI, SRPSKA DEMOKRATIJA, PARTIA BALLISTE dhe ALEANCA PËR ARDHMËRINË E KOSOVËS.

<i>Ndërlidhja:</i>	Rregullorja Nr. 01 / 2023 për Regjistrimin dhe Funksionimin e Partive Politike
<i>Treguesit</i>	1. Zhvillimi i procedurave të prokurimit, më së voni deri me datën 1 shkurt 2024, 2. Mbajta e trajnimit në pmes periudhës 5 - 15 shkurt 2024,
<i>Vlerësimi i resurseve:</i>	Pa kosto
<i>Sfidat nëse ka vonesa në realizimin e aktivitetit:</i>	
<i>Monitorimi nga përgjegjësi për koordinim dhe raportim - koment:</i>	Z.L. për Parti Politike në ZRCKFSP

Aktiviteti 58:	Dorëzimi i të dhënave vjetore të partive politike (Formularët e azhurnimit)
Statusi:	Realizuar
Zyrtari/ja përgjegjës/e:	Z.L. për Regjistrim dhe Certifikim në ZRPPC
Periudha e realizimit:	janar - shkurt 2024
Tjera:	/

#### Përshkrimi i realizimit të aktivitetit:

Në bazë të Rregullores Nr. 01 / 2023 për Regjistrimin dhe Funksionimin e Partive Politike, partia e regjistruar politike i kompletion dhe ia dorëzon Zyrës për Regjistrim, Certifikim dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike (Zyra) të dhënat e ndryshuara vjetore deri më 31 janar të çdo viti.

Nga pesëdhjetë (50) parti politike të regjistruara:

- Dyzet e gjashtë (46) parti politike të regjistruara kanë dorëzuar formularët e azhurnimit vjetorë, brenda afatit të caktuar (prej datës 3 deri 31 janar 2024);
- dy (2) parti politike të regjistruara kanë dorëzuar formularët e azhurnimit vjetor, pas datës 31 janar 2024;
- dy (2) parti politike nuk kanë dorëzuar formularin e azhurnimit vjetor.

Raporti dhe rekomandimi për shqiptimin e gjobave, është shqyrtuar në mbledhjen e KQZ, numër 08 / 2024, datë 15.02.2024.

<i>Ndërlidhja:</i>	Rregullorja Nr. 01/ 2023 për Regjistrimin dhe Funksionimin e Partive Politike
<i>Treguesit</i>	<ol style="list-style-type: none"> <li>Pranimi i formularëve të azhurnimit, më së voni me datën 31 janar 2024, ora 16:00;</li> <li>Numri i informatave shtesë të kërkuara nga ZRCKFSP, më së voni me datën 1 shkurt 2024;</li> <li>Raporti përfundimtar;</li> <li>Nr. i rekomandimet për shqiptimin e gjobave.</li> </ol>
<i>Vlerësimi i resurseve:</i>	Pa kosto
<i>Sfidat nëse ka vonesa në realizimin e aktivitetit:</i>	
<i>Monitorimi nga përgjegjësi për koordinim dhe raportim - koment:</i>	Z.L. për Regjistrim dhe Certifikim në ZRPPC

Aktiviteti 59:	Dorëzimi i formularëve për vazhdimin e regjistrimit
Statusi:	Realizuar
Zyrtari/ja përgjegjës/e:	Z.L. për Regjistrim dhe Certifikim në ZRPPC
Periudha e realizimit:	mars – prill 2024
Tjera:	/

#### Përshkrimi i realizimit të aktivitetit:

Sipas paragrafit 7, të nenit 13 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, secila parti politike e regjistruar, obligohet ta dorëzoj formularin për vazhdimin e regjistrimi, jo më vonë se 31 marsi i çdo viti kalendarik.

Partitë politike të regjistruara, kanë qenë të obliguara që të dorëzojnë në Zyrë, formularin për vazhdimin e regjistrimit, më së voni, me datën 31.03.2024.

Nga pesëdhjetë e dy (52) parti politike të regjistruara, formularin për vazhdim të regjistrimit e kanë dorëzuar, dyzet e shtatë (47) parti politike.

Për shkak të mos dorëzimit të formularit për vazhdimin e regjistrimi, Zyra i ka rekomanduar KQZ, çregjistrimin e partive politike, si në vijim:

- PARTIA URA;
- LËVIZJA FORCA E DIASPORËS.

<i>Ndërlidhja:</i>	Paragrafi 7, nen 13 I Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës
<i>Treguesit</i>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Pranimi i formularëve për vazhdimin e regjistrimit, më së voni me datën 31 mars 2024;</li> <li>2. Numri i raporteve të pranuara;</li> <li>3. Raporti përfundimtar;</li> <li>4. Nr. i rekomandimet për çregjistrimin e partive politike.</li> </ol>
<i>Vlerësimi i resurseve:</i>	Pa kosto
<i>Sfidat nëse ka vonesa në realizimin e aktivitetit:</i>	
<i>Monitorimi nga përgjegjësi për koordinim dhe raportim - koment:</i>	Z.L. për Regjistrim dhe Certifikim në ZRPPC

<i>Aktiviteti 60:</i>	Vëzhgimi i Kuvendeve Zgjedhore të Partive Politike të regjistruara
<i>Statusi:</i>	Realizuar
<i>Zyrtari/ja përgjegjës/e:</i>	Z.L. për Regjistrim dhe Certifikim të Subjekteve Politike dhe Z.L. Ligjor në ZRCKFSP
<i>Periudha e realizimit:</i>	Mars, qershori, shtator, dhjetor 2024
<i>Tjera:</i>	/

#### Përshkrimi i realizimit të aktivitetit:

Nga data 1 janar 2024, deri me datën 31 MARS 2024, janë mbajtur dhe vëzhguar gjithsejtë: gjashtë (6) kuvende zgjedhore të partive politike të regjistruar.

<b>Nr.</b>	<b>PARTIA POLITIKE</b>	<b>DATA E MBAJTJES SË KUVENDIT ZGJEDHOR</b>
1	LËVIZJA PËR BASHKËVEPRIM	18.01.2024
2	PARTIA ROME E BASHKUAR E KOSOVËS	18.01.2024
2	PARTIA SOCIALDEMOKRATE	28.01.2024
3	SOCIALDEMOKRATSKA UNIJA	03.02.2024
4	SRPSKA DEMOKRATIJA	28.02.2024
5	DEMOKRATSKA STRANKA BOŠNJAKA	09.03.2024

- Partitë politike të regjistrues: LËVIZJA PËR BASHKËVEPRIM dhe PARTIA SOCIALDEMOKRATE, kanë qenë të pezulluar me vendim të KQZ (vendimet e muajit dhjetor 2023) të cilat, brenda afatit në vendim për pezullim, kanë mbajtur kuvendet zgjedhore.
- Partia politike PARTIA ROME E BASHKUAR E KOSOVËS, po ashtu ka qenë e pezulluar me vendim të KQZ, ku brenda afatit, ka mbajtur kuvendenin zgjedhor.

<i>Ndërlidhja:</i>	Rregullorja Nr. 01 / 2023 për Regjistrimin dhe Funksionimin e Partive Politike
<i>Treguesit</i>	1. Informatat nga vëzhgimet e Kuvendeve Zgjedhore raportohen në kuadër të raportimit të realizimit të planit të punës për çdo tre muaj.
<i>Vlerësimi i resurseve:</i>	Pa kosto
<i>Sfidat nëse ka vonesa në realizimin e aktivitetit:</i>	
<i>Monitorimi nga përgjegjësi për koordinim dhe raportim - koment:</i>	Z.L. për Regjistrim dhe Certifikim të Subjekteve Politike dhe Z.L. Ligjor në ZRCKFSP

Aktiviteti 61:	Publikimi i raporteve vjetore financiare
Statusi:	Realizuar
Zyrtari/ja përgjegjës/e:	Z.L. për Parti Politike në ZRCKFSP
Periudha e realizimit:	mars – maj 2024
Tjera:	/

#### Përshkrimi i realizimit të aktivitetit:

Sipas Ligjit për Financimin e Subjekteve Politike, subjektet politike të regjistrues, obligohen që të dorëzojnë në KQZ, për çdo vit, raportin vjetor financier, më së largu me datën 1 mars të vitit pasues. Për periudhën raportuese 01.01.2023 - 31.12.2023, pesëdhjetë e katër (54) subjektet politike, kanë qenë të obliguar që të dorëzojnë raportet vjetore financiare, në Zyrën për Regjistrimin, Certifikimin dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike (Zyra). Nga muaji janar 2024, deri me datën 01.03.2024, Zyra ka pranuar gjithsejtë, pesëdhjetë e një (51) raporte vjetore financiare. Dyzet e shtatë (47) parti politike të regjistrues, kanë dorëzuar raportet vjetore financiare të vitit 2023, ndërsa katër (4) subjekte politike të përfaqësuara në Kuvenden e Kosovës, kanë dorëzuar raportet vjetore financiare të vitit 2023.

Tri (3) parti politike të regjistrues, nuk kanë dorëzuar raportet vjetore financiare të vitit 2023, siç obligohen me Ligjin për Financimin e Subjekteve Politike: PARTIA SHQIPTARE

DEMOKRISTIANE E KOSOVËS, PARTIA DEMOKRATIKE E ASHKANLIVE TË KOSOVËS dhe EKO LËVIZJA E GJELBËR.

Raportet vjetore financiar të vitit 2023, janë publikuar 14.03.2024.

<i>Ndërlidhja:</i>	Neni 19/A i Ligjit për Financimin e Subjekteve Politike
<i>Treguesit</i>	1. ZRCKFSP harton raport për dorëzimin e raporteve vjetore të partive politike; 2. Shqiptimi i gjabave për mos dërgim të raporteve brenda afatit ligjor.
<i>Vlerësimi i resurseve:</i>	Pa kosto
<i>Sfidat nëse ka vonesa në realizimin e aktivitetit:</i>	
<i>Monitorimi nga përgjegjësi për koordinim dhe raportim - koment:</i>	Z.L. për Parti Politike në ZRCKFSP

<i>Aktiviteti 62:</i>	Auditimin e raporteve vjetore financiare të vitit 2023 dhe auditimi i raporteve të deklarimit financiar për zgjedhjet e vitit 2023
<i>Statusi:</i>	Realizuar
<i>Zyrtari/ja përgjegjës/e:</i>	Drejtori i ZRCKFSP dhe Z.L. për Parti Politike
<i>Periudha e realizimit:</i>	janar – nëntor 2024
<i>Tjera:</i>	/

Përshkrimi i realizimit të aktivitetit:

Operatori ekonomik "Audit&Conto" ka audituar gjithsejtë pesëdhjetë e katër (54) subjekte politike, për periudhën reportuese 01.01.2023 – 31.12.2023. Nga 54 subjekte politike gjithsejtë, 15 subjekte politike të përfaqësuara në Kuvendin e Republikës së Kosovës, përfitojnë mjete financiare nga Fondi për mbështetjen e subjekteve politike. Zyra, me datën 25.06.2024, nga operatori ekonomik, ka pranuar raportet përfundimtare të auditimit. Me datën 28.06.2024, Zyra, përmes e-mailit, i kishte dërguar të gjitha raportet përfundimtare të auditimit, në adresat elektronike të kryetarëve të subjekteve politike dhe përfaqësuesve të tyre financiar.

<i>Ndërlidhja:</i>	Neni 19 i Ligjit për Financimin e Subjekteve Politike
<i>Treguesit</i>	1. Më së voni, me datën 20.01.2024, shpallen procedurat për përzgjedhjen e auditorëve për auditimin e raporteve vjetore financiare të vitit 2023 dhe auditimin e raporteve financiare të fushatës së zgjedhjeve të vitit 2023; Më së voni, deri me datën 20 mars 2024, përfundon përzgjedhje e auditorëve për auditim të raporteve financiare;

	3. Më së voni, deri me datën 30 qershor 2024, raportet përfundimtare të audituara publikohen në ueb faqen e KQZ; 4. ZRCKFSP shqipton gjobat në përputhje me LFSP, nga muaji qershor deri në muajin nëntor 2024.
Vlerësimi i resurseve:	240,000 Euro, KQZ
Sfidat nëse ka vonesa në realizimin e aktivitetit:	
Monitorimi nga përgjegjësi për koordinim dhe raportim - koment:	Drejtori i ZRCKFSP, Z.L. për Parti Politike

Aktiviteti 64:	Shqiptimi i gjobave për shkeljet e LFSP	
Statusi:	Realizuar	Aktivitet i planifikuar prej muajit qershor 2024
Zyrtari/ja përgjegjës/e:	ZRCKFSP	
Periudha e realizimit:	Qershor – nëntor 2024	
Tjera:	/	

#### Përshkrimi i realizimit të aktivitetit:

Për të gjeturat nga raportet përfundimtare të auditimit për pasqyrat vjetore financiare 2023, Zyra ka shqiptuar gjithsejtë: njëzet (20) gjoba, që përfshijnë gjithsejtë: katërmëbëdhjetë (14) subjekte politike.

Nga katërmëbëdhjetë (14) subjekte politike, gjobat janë shqiptuar për:

- Shtatë (7) subjekte politike, përfaqësohen në Kuvendin e Republikës së Kosovës;
- Shtatë (7) subjekte politike, nuk përfaqësohen në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Ndërlidhja:	Neni 21, i Ligjit për Financimin e Subjekteve Politike
Treguesit	1. Numri i vendimeve të marra. 2. Numri i shkresave për institucionet tjera.
Vlerësimi i resurseve:	Pa kosto
Sfidat nëse ka vonesa në realizimin e aktivitetit:	
Monitorimi nga përgjegjësi për koordinim dhe raportim - koment:	Z.L. për Parti Politike

Aktiviteti 65:	Organizimi i trajnimit për personat kontaktues ose përfaqësues të subjekteve politike.
Statusi:	<u>Rekomandim:</u> Te shtyhet deri ne tetor 2024
Zyrtari/ja përgjegjës/e:	ZRCKFSP
Periudha e realizimit:	Prill - maj 2024
Tjera:	/

Përshkrimi i realizimit të aktivitetit:

Rekomandim: Te shtyhet deri ne tetor 2024

Ndërlidhja:	Plani Strategjik 2023 - 2026
Treguesit	1. Organizimi në grupe, në lidhe me trajnimin për përdorimin e polatformës për certifikim të subjekteve politike dhe akreditim të vëzhguesve; 2. Hartimi i raportit për ecurinë e trajnimit;
Vlerësimi i resurseve:	Pa kosto
Sfidat nëse ka vonesa në realizimin e aktivitetit:	
Monitorimi nga përgjegjësi për koordinim dhe raportim - koment:	Z.L. për Regjistrim dhe Certifikim në ZRPPC, Z.L. Ligjor në ZRCKFSP

Aktiviteti Nr. 66	Marrëveshje bashkëpunimi me institucionet e Republikës së Kosovës për verifikim të kandidatëve
Statusi:	<b>Në proces</b>
Zyrtari/ja përgjegjës/e:	Z.L. për Regjistrim dhe Certifikim në ZRPPC/ Z.L. Ligjor në ZRCKFSP
Periudha e realizimit:	tetor – nëntor 2024
Tjera:	/

Drafti i parë i dokumentit “Marrveshje bashkëpunimi me institucionet e Republikës së Kosovës për verifikim të kandidatëve”, është hartuar nga Zyra, dhe me datën 05.09.2024, është dërguar përmes e-mailit, tek anëtarët e Këshillit për Operacione Zgjedhore.

Aktiviteti 67:	Hartimi procedurave dhe udhëzuesve për subjektet politike
Statusi:	<b>Në proces</b>
Zyrtari/ja përgjegjës/e:	Z.L. për Regjistrim dhe Certifikim në ZRPPC/ Z.L. Ligjor në ZRCKFSP
Periudha e realizimit:	janar - prill 2024
Tjera:	/

Përshkrimi i realizimit të aktivitetit:

Në muajin maj të vitit 2024, Zyra ka hartuar procedurat standarde të operimit për cështjet që kanë të bëjnë me regjistrimin e partive politike, certifikimin e subjekteve politike dhe akreditimin e vëzhguesve në zgjedhje. Të tri (3) procedurat, janë dërguar përmes e-mailit, tek anëtarët e Këshillit për Operacione Zgjedhore, me datën 29.05.2024.

<i>Ndërlidhja:</i>	Plani Strategjik i KQZ 2023 - 2026, Rregullorja Nr. 01/ 2023 dhe Rregullorja Nr. 04/ 2023
<i>Treguesit</i>	Numri i procedurave të hartuara dhe miratuara.
<i>Vlerësimi i resurseve:</i>	Pa kosto
<i>Sfidat nëse ka vonesa në realizimin e aktivitetit:</i>	
<i>Monitorimi nga përgjegjësi për koordinim dhe raportim - koment:</i>	Z.L. për Regjistrim dhe Certifikim në ZRPPC, Z.L. Ligjor në ZRCKFSP

<i>Aktiviteti 68:</i>	Platforma online për raportim finansiar
<i>Statusi:</i>	Realizuar
<i>Zyrtari/ja përgjegjës/e:</i>	Drejtori i ZRCKFSP dhe Z.L. për Parti Politike
<i>Periudha e realizimit:</i>	janar - maj 2024
<i>Tjera:</i>	/

#### Përshkrimi i realizimit të aktivitetit:

Operatori ekonomik, i përgjedhur nga UNDP - Misioni në Kosovë, ka realizuar platformën për raportim finansiar, e cila është dorëzuar në Zyrë.

<i>Ndërlidhja:</i>	Plani Strategjik 2023 - 2026
<i>Treguesit</i>	1. Dizjanimi i platformës; 2. Trajnim i dhe testimi.
<i>Vlerësimi i resurseve:</i>	Me kosto, UNDP
<i>Sfidat nëse ka vonesa në realizimin e aktivitetit:</i>	
<i>Monitorimi nga përgjegjësi për koordinim dhe raportim - koment:</i>	Drejtori i ZRCKFSP, Z.L. për Parti Politike

<i>Aktiviteti 69:</i>	Zbatimi i projektit për transparencë të mbledhjeve të KQZ-së
<i>Statusi:</i>	Në proces
<i>Zyrtari/ja përgjegjës/e:</i>	DTIZShV / Zëdhënësi i KQZ
<i>Periudha e realizimit:</i>	Shkurt - dhjetor 2024

Tjera:

/

#### Përshkrimi i realizimit të aktivitetit:

Duke u bazuar në Planin e Punës dhe Planin e Prokurimit për vitin 2024, është përgatitur projektim dhe i njëjtë është proceduar për prokurim. Qëllimi i këtij aktiviteti është furnizimi me me pajisje të zerimit&përkthimit dhe transmetimit live dhe pajisjeve të tjera për sallën e KQZ-së. Kjo për të plotësuar obligimet ligjore të KQZ-së dhe për të siguruar një mjedis efikas dhe transparent për takimet e rregullta. Pajisjet audio përdoren për përkthim të diskutimeve në kohë reale dhe për incizim të tingullit gjatë takimeve.

Në të njëjtën kohë, qëllim tjetër është transmetim live i mbledhjeve të KQZ-së, duke u bazuar në kërkesat ligjore dhe praktikat duke synuar që KQZ të përmirësojë transparencën dhe të sigurojë qasje të gjerë për të interesuarit në procesin e vendimmarrjes. Sipas planifikimeve buxhetore, përmes këtij projekti do të bëhet furnizimi me pajisje për livetream të mbledhjeve të KQZ-së dhe pajisjeve tjera për përcjelljen e aktiviteteve zgjedhore ku përfshihen tabelë interaktive digitale dhe TV. Aktiviteti fillimit është iniuar me datë 05.04.2024 për pjesën e transmetimit live, mirëpo sipas informatave nga zyra e prokurimit në mungesë të ofertave të përgjegjshme aktiviteti është anuluar. Përsëri me datë 14.06.2024, është proceduar në zyrën e prokurimit aktiviteti i plotësuar i cili ka të përfshirë pajisje të zerimit&përkthimit, transmetimit live dhe ekraneve/TV për sallën e KQZ.

Ndërlidhja:	Plani Strategjik i KQZ-së 2023-2026 ( A.72 )
Treguesit	1. Projekti i detajuar i hartuar dhe aprovuar. 2. Termat e referencës të aprovuar 3. Transmetimi i mbledhjeve të KQZ-së online
Vlerësimi i resurseve:	45,500 Euro, KQZ
Sfidat nëse ka vonesa në realizimin e aktivitetit:	
Monitorimi nga përgjegjësi për koordinim dhe raportim - koment:	Drejtori i DTIShV

Aktiviteti 70:	Bashkëpunimi i rregullt me organizata dhe institute që merren me zgjedhje dhe aplikimi për anëtarësim në organizatat e reja
Statusi:	Në proces
Zyrtari/ja përgjegjës/e:	SKQZ / ZRCKFSP
Periudha e realizimit:	Shkurt - dhjetor 2024
Tjera:	/

### Përshkrimi i realizimit të aktivitetit:

Gjatë tre mujroit të parë (T1), në kuadër të aktivitetit për bashkëpunimin e Rregullt KQZ me organizata tjera, në muajin janar KQZ ka kontribuar në Buletinin e A-ËEB për muajin Janar 2024 (A-ËEB NEËSLETTER (January 2024)), që përfshin edhe lajmet nga KQZ Kosovë me tri lajme si dhe gjatë T1 ka marrë pjesë në konferenca dhe trajnime të organizuara nga IFES, NEC Koreja e Jugut dhe ODIHR.

- Nga ODIHR KQZ ka marr ftesë për pjesëmarrje në konferencën "Shkëmbim Rajonal mbi Forcimin e Sistemeve dhe Praktikave Financiare të Fushatës" në Varshavë ku nga KQZ kanë marrë pjesë kryesuesi i KQZ, Drejtori i ZRCKFSP dhe zyrtarja nga ZRCKFSP.
- Ftesë për takim online nga Rrjeti i Drejtësisë Zgjedhore për Evropën dhe Eurazinë-IFES, kryesuesi i KQZ dhe anëtari i KQZ.
- Ftesës për Programin Ndërkombëtar të Vëzhgimit të Zgjedhjeve (EOP) për Zgjedhjet e Asamblesë Kombëtare të Republikës së Koresë, kryesuesi i KQZ dhe anëtari i KQZ.
- Pjesëmarrjes së KQZ-së në punëtorinë "Mbikëqyrja e Financave te partive Politike" në Pragë, Republika Çeke, Drejtori i ZRCKFSP dhe zyrtarja nga ZRCKFSP.
- Pjesëmarrje në Programin për ngritjen e kapaciteteve të trupave zgjedhorë 2024, katër (4) zyrtarë nga Sekretariati i KQZ, i mbajtur në Seul, Koreja e Jugut nga datat 11 qershori - 19 qershori 2024.

<i>Ndërlidhja:</i>	Plani Strategjik i KQZ-së 2023-2026 ( A.89 )
<i>Treguesit</i>	1. Organizatat e identifikuara 2. Regjistri me aktivitete të cilat mbështeten nga organizatat
<i>Vlerësimi i resurseve:</i>	Pa kosto
<i>Sfidat nëse ka vonesa në realizimin e aktivitetit:</i>	
<i>Monitorimi nga përgjegjësi për koordinim dhe raportim - koment:</i>	SKQZ/ZRCKFSP

<i>Aktiviteti 71:</i>	Organizimin i takimeve dhe punetorisë në mes KQZ e Kosoves dhe Shqiperisë
<i>Statusi:</i>	<b>Në process - Propozhet të shtyhet deri ne shtator 2024</b>
<i>Zyrtari/ja përgjegjës/e:</i>	SKQZ/ZRCKFSP
<i>Periudha e realizimit:</i>	Janar - qershori
<i>Tjera:</i>	/

### Përshkrimi i realizimit të aktivitetit:

Sekretariati i KQZ-së ka përgatitur temat të cilat do të mund të diskutohen takimet e përbashkëta mes KQZ të Kosovës dhe KQZ të Shqipërisë.

KQZ e Kosovës ka kërkuar që ky format i takimit të shfrytëzohet për të prezantuar dhe diskutuar rreth temave që kanë të bejnë më por nuk kufizohen:

- a) perdonimi i teknologjise dhe kamerave ne qendrat komunale te numerimit, dhe vendvotim,
- b) identifikimi elektronik i votuesve
- c) raportimi digjital i finanancave të partive politike
- d) ntelegjenca artificiale ne procesin e zgjedhjeve,

**Organizimi i projektit te takimit mes KQZ e Kosovës dhe KQZ e Shqipërisë-** janë caktuar përgjegjësit të organizimit të takimit Valmir Elezi dhe Argjina Misini, dhe poashtu janë duke u trajtuar temat e propozuara nga KQZ të cilat do të diskutohen. Grupi punues ka për detyrë të përgatitit projektin që përfshin koston e shpenzimeve, agjendën protokollin si dhe aspekte tjera të organizimit.

<i>Ndërlidhja:</i>	
Treguesit	1. Së paku dy takime të mbajtura dhe një punëtori
Vlerësimi i resurseve:	10,000 Euro, KQZ
<i>Sfidat nëse ka vonesa në realizimin e aktivitetit:</i>	
<i>Monitorimi nga përgjegjësi për koordinim dhe raportim - koment:</i>	SKQZ/ZRCKFSP

### 3 PROGRESI NË ZBATIMIN E PLANIT TË PUNËS

Në planin e punës së KQZ për vitin 2024, janë paraparë të realizohen 71 aktivitete.

Shtyllat strategjike	Numri i aktiviteteve
Shtylla Strategjike 1 - Qëndrueshmëria dhe fuqizimi institucional	30
Shtylla Strategjike 2 - Korniza ligjore	3
Shtylla Strategjike 3 - Gjithëpërfshirja dhe pjesëmarrja në zgjedhje	15
Shtylla Strategjike 4 - Inovacioni dhe teknologjia	7
Shtylla Strategjike 5 - Bashkëpunimi dhe transparenca	16
Gjithsejt	71

Tabela 2. Aktivitetet e planit të punës sipas shtyllave

Në periudhën janar – qershor 2024 janë realizuar gjithsejtë 21 aktivitete apo 29.58% në raport me gjithë aktivitetet e Planit të Punës së KQZ. Disa aktivitete edhe përkundër planit që realizimin e kanë pasur në vitin 2023, për arsyet e ndryshme nuk kanë mundur të realizohen dhe janë bartur për vitin 2024.

- aktivitete që deri me tani janë realizuar janë 21 aktivitete apo 29.58%,
- aktivitete të realizuara për këtë periudhë janë 5 apo 7.04 %,
- aktivitete që janë në proces janë 35 apo 49.30%,
- aktivitete që nuk kanë filluar dhe që periudha e fillimit të tyre nuk fillon në T2 janë 7 apo 9.86%, dhe
- aktivitete që nuk kanë filluar akoma eshe pse periudhen e fillimit e kane në T2 janë 2 aktivitete apo 5.71%,


## REALIZIMI I AKTIVITETEVE TË PLANIFIKUARA NË T2

Në tre mujorin e dytë T2 janë planifikuar të realizohen tridhjetëetre (33) aktivitete dhe prej tyre brenda afatit janë realizuar gjithsejt njëzetëenjë (21) aktivitete, dy (2) aktivitete nuk janë realizuar.

Aktivitete të planifikuara në	
T2	35
Të realizuara	21 60.00%
Në proces	10 28.57%
Nuk është realizuar	4 11.43%

Tabela 3. Aktivitete e planifikuara dhe statusi i realizimit të tyre në tre mujorin e parë T1


Realizimi i aktivitetave të planifikuara në T1



Grafika 1. Aktivitete të planifikuara për realizim në muajin mars-qershor 2024 dhe realizimi i tyre në tre mujorin e dytë T2

	Statusi	Gjithsejt	Përqindja
Realizuar		21	29.58%
Realizuar për këtë periudhë		5	7.04%
Në proces		35	49.30%
Nuk ka filluar		8	11.27%
Nuk është realizuar		2	2.82%
Gjithsejt aktivitete		71	

Tabela 4. Numri i aktiviteteve të realizuara të planit të punës së KQZ 2024 për periudhën janar - mars 2024



Grafika 2. Përqindja e realizimit të planit të punës së KQZ 2024 për periudhën janar - mars 2024

15 -08- 2024

Prishtinë / Priština



Republika e Kosovës 011185-2024  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komisioneri Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission



**CENTRALNA IZBORNA KOMISIJA**, u skladu sa ovlašćenjima datih članom 63. i članom 64. të Ligjit Nr.08/L-228 Zakona br.08/L-228 o opštim izborima u Republici Kosovo, kao i odlukom CIK-a br.01/20-2024, od 12.01.2024. godine, za usvajanje plana rada CIK-a za 2024. godinu, na redovnom sastanku održanom 15.08.2024, donosi:

## ODLUKA

### Za usvajanje pregleda Plana rada CIK-a 2024

- I. Usvaja se pregled Plana rada CIK-a 2024. godine.
- II. Izveštaj kao u tački I të këtij vendimi, sastavni je deo ove odluke.
- III. Obavezuje se Sekretariat CIK-a za sprovođenje ove odluke.
- IV. Ova odluka stupa na snagu danom potpisivanja.

Priština, 15.08.2024

Predsedavajući  
Centralna izborna komisija





Datë / Datum	03.04.2024	Referencë/e	
Për/ Za	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve		
Nga/ Od	Burim Ahmetaj, Kryeshef Ekzekutiv i Sekretariatit të KQZ-së		
Tema/ Subjekat	Rishikimi i Planit të Punës së KQZ 2024		

Në planin e Punës së KQZ për vitin 2024 është aktiviteti që ka për qëllim rishikimin e planit të punës.

Rishikimi i planit të punës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) për vitin 2024 është një proces i rëndësishëm që ndihmon në përshtatjen e aktiviteteve dhe prioriteteve të KQZ-së në përputhje me ndryshimet ligjore dhe institucionale që mund të ndodhin gjatë vitit. Ky proces përfshin shqyrtimin periodik të objektivave, strategjive dhe aktiviteteve për të siguruar se ato janë të përshtatshme për periudhën aktuale dhe sigurimi që plani i punës përputhet me nevojet dhe pritet e KQZ.

- Vlerësimi i aktiviteteve:** Sekretariati i KQZ dhe ZRCKFSP kanë bërë një vlerësim dhe analizë të punës së kryer deri në momentin aktual dhe kanë identifikuar realizimin dhe sfidat e hasura. Ky vlerësim ndihmon në përcaktimin e fushave që kërkojnë përmirësimë ose rregullime.
- Përcaktimi i objektivave të reja:** Bazuar në vlerësimet dhe analizat, KQZ mund të vendosë objektiva të reja që synojnë përmirësimin e procesit zgjedhor, rritjen e transparencës, dhe përmirësimin e marrëdhënieve me palët e interesuara.
- Përditësimi i planifikimeve dhe buxhetit:** Çdo rishikim kërkon përditësimë në planin operacional dhe buxhetin e KQZ-së për t'u siguruar që resurset përdoren në mënyrë efektive përritjen e objektivave të reja.
- Konsultimi me palët e interesuara:** KQZ mund të përfshijë edhe palët e interesuara, si partitë politike, organizatat e shoqërisë civile, dhe ndërkombëtarë, në procesin e rishikimit për të siguruar që plani i ri i punës përfaqëson interesat e të gjitha palëve.
- Publikimi dhe transparenca:** Pas rishikimit, KQZ zakonisht publikon planin e ri të punës për të siguruar transparencë dhe për të informuar publikun dhe institucionet relevante mbi ndryshimet e bëra.
- Analiza e prioriteteve:** Njesitë përgjegjëse kanë bërë një analizë dhe vlerësim të aktiviteteve të cilat nuk kanë mundur të realizohen sipas kohës së përcaktuar në Planin e Punës, të cilat kanë rëndësi strategjike dhe që duhet të përmbushen sipas afateve të propozuara/planifikuara me rishikim pasi që këto aktivitete lidhen drejtpërdrejt me procesin zgjedhor ose me detyra të tjera që janë thelbësore për funksionimin e institucionit.

Në lidhje me këtë Sekretariati i KQZ dhe ZRCKFSP kanë identifikuar disa aktivitete të planit të punës të KQZ-së për vitin 2024 të cilat për shkak të mbingarkesës me aktivitete të tjera, shtyrja e afatit te realizimit të tyre mund të jetë i nevojshëm për të menaxhuar më mirë kohën dhe resurset dhe vet realizimin e aktiviteteve.

ZRCKFSP për dy aktivitete ka rekomanduar largimin e tyre nga Plani i Punës së KQZ 2024

#### **Rekomandim për Miratimin e Rishikimit të Planit të Punës së KQZ-së për Vitin 2024**

Duke marrë parasysh ndryshimet e fundit në legjislacionin zgjedhor, rritjen e numrit të aktiviteteve dhe nevojën për një menaxhim më të efektshëm të burimeve, propozohet miratimi i rishikimit të planit të punës së Komisionit Qendoror të Zgjedhjeve (KQZ) për vitin 2024. Ky rishikim do të mundësojë që KQZ të përmbushë detyrat e saj ligjore dhe operacionale në mënyrë efikase.

**Rekomandim 1:** Bazuar në arsyet e mësipërme, rekomandohet Komisioni Qendoror i Zgjedhjeve të miratojë rishikimin e planit të punës së KQZ-së për vitin 2024 që do t'i mundësojë që KQZ-së të përmbushë në mënyrë të përgjegjshme dhe efikase detyrat e saj të përcaktuara në planin e punës së KQZ 2024.

dhe

**Rekomandim 2:** Aktiviteti nr. 65, Organizimi i trajnimit për personat kontaktues ose përfaqësues të subjekteve politike dhe anaktiviteti nr. 66 Marrëveshje bashkëpunimi me institucionet e Republikës së Kosovës për verifikim të kandidatëve ZRCKFSP ka vlerësuar se këto dy (2) aktivitete nuk mund te realizohen andaj rekomandohet Komisioni Qendoror i Zgjedhjeve që aktiviteti nr. 65 dhe 66 të largohen nga Plani i Punës i KQZ.

### Aktivitetet për të cilat rekomandohet shtyrja e afatit të realizimit

Aktiviteti 19:	Organizimi i takimeve të KQZ-së me Kryetar të Komunave dhe me Kryesuesit e Kuvendeve Komunale										
Statusi:	Në proces Propozohet të shtyhet deri ne shtator 2024										
Zyrtari/ja përgjegjës/e:	Drejtori i DOZEIAT										
Periudha e realizimit:	Janar – mars 2024										
I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII

Aktiviteti 25:	Lista e Rezqiqeve										
Statusi:	Nuk ka filluar Propozohet të shtyhet deri ne tetor 2024										
Zyrtari/ja përgjegjës/e:	Grupi Punues										
Periudha e realizimit:	Qershori 2024										
I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII

Aktiviteti 30:	Simulimi i procesit zgjedhor										
Statusi:	Në proces Propozohet të shtyhet deri ne shtator 2024										
Zyrtari/ja përgjegjës/e:	Drejtori i DOZEIAT										
Periudha e realizimit:	Shkurt – korrik 2024										
I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII

Aktiviteti 31:	Miratimi i ndryshim plotësimit të Rregulloreve zgjedhore										
Statusi:	Në process - Propozohet të shtyhet deri ne shtator 2024										
Zyrtari/ja përgjegjës/e:	Grupi Punues										
Periudha e realizimit:	Janar – shkurt 2024										
I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII

Aktiviteti 33:	Miratimi i Rregulloreve të brendshme të KQZ-së										
Statusi:	Në proces - aktiviteti propozohet të shtyhet deri ne nëntor 2024										
Zyrtari/ja përgjegjës/e:	Drejtor i ZRCKFSP / Drejtor i DCL / Drejtor i DAP										
Periudha e realizimit:	janar - shkurt 2024										
I II III IV	V VI VII VIII IX X XI XII										

Aktiviteti 36:	Analizë dhe hulumtim i planeve te detajuara për infomim										
Statusi:	Në proces aktiviteti propozohet të shtyhet deri ne nëntor 2024										
Zyrtari/ja përgjegjës/e:	Ekseprt i Jashtem										
Periudha e realizimit:	Janar - mars 2024										
I II III IV	V VI VII VIII IX X XI XII										

Aktiviteti 45:	Analizë e Qendrave të Votimit brenda Vendit										
Statusi:	Në proces aktiviteti propozohet të shtyhet deri ne shtator 2024										
Zyrtari/ja përgjegjës/e:	DOZEIAT/ DTIZ										
Periudha e realizimit:	Shkurt - prill 2024										
I II III IV	V VI VII VIII IX X XI XII										

Aktiviteti 47:	Organizimi i takimeve informuese me akteret zgjedhor										
Statusi:	Në proces aktiviteti propozohet të shtyhet deri ne shtator 2024										
Zyrtari/ja përgjegjës/e:	DOZEIAT										
Periudha e realizimit:	Shkurt - qershori 2024										
I II III IV	V VI VII VIII IX X XI XII										

Aktiviteti 51:	Rishikimi i të gjithë formave zgjedhor dhe ridizajnimi i formave të identifikuara gjatë rishikimit										
Statusi:	Në proces aktiviteti propozohet të shtyhet deri ne shtator 2024										
Zyrtari/ja përgjegjës/e:	DOZEIT/DTIZShV										
Periudha e realizimit:	Janar - qershor 2024										
I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII

Aktiviteti 54:	Dizajnimi i ueb fakes së KQZ për informatat që kanë të bëjnë me regjistrimin dhe certifikimin e subjekteve politike dhe raportimin financiar										
Statusi:	Në proces Zbatimi i këtij aktiviteti duhet të zhvendoset në periudhën kohore gusht – tetor 2024 (Tre mujorin e III dhe të IV).										
Zyrtari/ja përgjegjës/e:	Drejtori i ZRCKFSP										
Periudha e realizimit:	Janar - prill 2024										
I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII

Aktiviteti 56:	Regullorja për mbikëqyrjen vjetore financiare të partive politike dhe mbikëqyrjen financiare të fushatës së zgjedhjeve										
Statusi:	Në proces Zbatimi i këtij aktiviteti duhet të zgjatet për periudhën kohorë deri në gusht të vitit 2024 (Tre mujori III).										
Zyrtari/ja përgjegjës/e:	Drejtori i ZRCKFSP/ Z.L. për Parti Politike dhe Z.L. Ligor në ZRCKFSP										
Periudha e realizimit:	janar - mars 2024										
I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII

Aktiviteti 71:	Organizimin i takimeve dhe punetorisë në mes KQZ e Kosoves dhe Shqiperisë										
Statusi:	Në process - Propozhet të shtyhet deri ne shtator 2024										
Zyrtari/ja përgjegjës/e:	SKQZ/ZRCKFSP										
Periudha e realizimit:	Janar - qershor										
I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII

**Aktivitetet që rekomandohen të largohen nga Plani i Punës së KQZ 2024**

Aktiviteti 65:	Organizimi i trajnimit për personat kontaktues ose përfaqësues të subjekteve politike.
Statusi:	Në process - Propozhet të shtyhet deri ne tetor 2024
Zyrtari/ja përgjegjës/e:	ZRCKFSP
Periudha e realizimit:	Prill - maj 2024
I II III IV	V VI VII VIII IX X XI XII

Aktiviteti Nr. 66	Marrëveshje bashkëpunimi me institucionet e Republikës së Kosovës për verifikim të kandidatëve
Statusi:	Në process - Propozhet të shtyhet deri ne tetor 2024
Zyrtari/ja përgjegjës/e:	Z.L. për Regjistrim dhe Certifikim në ZRPPC/ Z.L. Ligjor në ZRCKFSP
Periudha e realizimit:	tetor – nëntor 2024
I II III IV	V VI VII VIII IX X XI XII



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission

Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission

15 -08- 2024

Prishtinë / Priština

Nr./Br. 0111187-2024

**CENTRALNA IZBORNA KOMISIJA**, u skladu sa ovlašćenjima datih članom 63. i 64.2 podstav 2.1 i 2.2, kao i članom 127. Zakona br.08/L-228 o opštim izborima u Republici Kosovo, na redovnom sastanku održanom 15.08.2024, donosi:

### ODLUKA

#### O usvajanju Internog pravilnika br.13/2024 o korišćenju i upravljanju vozilima CIK-a

- I. Usvaja se Interni pravilnik br.13/2024 o korišćenju i upravljanju vozilima CIK-a.
- II. Pravilnik kao u tački I, je sastavni deo ove odluke.
- III. Ova odluka stupa na snagu danom potpisivanja.

Priština, 15.08.2024

Predsedavajući





**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE (KQZ)**, në mbështetje të nenit 64.2 nën paragrafi 2.1 dhe nenin 66 paragrafi 2 i Ligji Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, si dhe nenin 22 paragrafi 7 i Rregullores së Brendshme Nr.10/2024 për Shtesat dhe Kompensimet në KQZ, me datë 15/08/2024, miraton këtë:

**RREGULLORE E BRENDSHME NR.13/2024 PËR SHFRYTËZIMIN DHE  
MENAXHIMIN E ATOMJETEVE NË KQZ**

**Neni 1  
Qëllimi**

Rregullorja ka për qëllim të rregulloj mënyrën e shfrytëzimit të automjeteve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (në vijim: KQZ).

**Neni 2  
Fushëveprimi**

Kjo Rregullore zbatohet për anëtarët e KQZ dhe të gjithë të punësuarit në KQZ.

**Neni 3  
Përkufizimet**

Termat dhe shprehjet e përdorura në këtë Rregullore kanë kuptimin e përcaktuar me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP).

**Neni 4  
E drejta për përdorimin e automjeteve zyrtare**

1. Kryesuesi i KQZ, Anëtarët e KQZ-së, Drejtori i Sekretariatit të KQZ-së dhe Drejtori i Zyrës për Regjistrim, Certifikim dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike (ZRCKFSP), mund ta shfrytëzojnë dhe përdorin automjetin zyrtar për kryerjen e punëve zyrtare gjatë 24 orëve brenda dhe, jashtë vendit.

- 1.1. nëse në relacionin e njëjtë udhëtojnë më shumë se një i punësuar sipas paragrafit 1 të këtij neni, të njëjtit mund të shfrytëzojnë një (l) automjet zyrtar.
- 1.2. sipas nevojës veturat mund të shfrytëzohen për nevoja të tjera të KQZ-së.
2. Zyrtarët tjere në KQZ për kryerjen e punëve zyrtare, mund të shfrytëzojnë automjetin zyrtar, me autorizim të Drejtorit të Sekretariatit të KQZ-së.
3. Nëse KQZ, nuk ka mundësi që udhëtimin zyrtar brenda dhe jashtë vendit ta organizojë me automjete zyrtare, autorizon zyrtarin për shfrytëzimin e automjetit privat dhe bën kompensimin e shpenzimeve të derivateve sipas kësaj Rregullore dhe Rregullore së Brendshme Nr.10/2024 për Shtesat dhe Kompensimet në KQZ.

**Neni 5**  
**Përdorimi i automjeteve zyrtare për Sekretariatin e KQZ**

1. Përgjegjës për lejimin e shfrytëzimit dhe të përdorimit të automjetit zyrtar, është Drejtori i Sekretariatit të KQZ-së dhe në mungesë të tij personi i autorizuar nga drejtori.
2. Zyrtari, i cili ka nevojë ta përdorë automjetin, duhet ta plotësojë kërkesën për shërbime të vozítjes brenda vendit (shtojca I), të cilën e aprovon Drejtori i Sekretariatit të KQZ-së.
3. Në rastet kur zyrtarët kërkojnë shërbimet e vozítjes nga zyrtari i transportit, kërkesa bëhet përmes email-it zyrtar tek Zyrtari i Transportit duke e mbajtur të informuar edhe Drejtorin e departamentit përkatës, dhe Drejtorin e departamentit të financave dhe shërbimeve të përbashkëta. Në listën e fletudhëtimit evidentohen kilometrat, destinacioni, zyrtari që udhëton dhe Zyrtari i transportit.
4. Kërkesa konsiderohet e aprovar, përjashtimisht rasteve kur nuk ka veturë në dispozicion.
5. Çdo drejtues i automjetit zyrtar, është i obliguar që në kërkesë të shënojë momentin e nisjes, destinimin e udhëtimit, qëllimin e udhëtimit, momentin e kthimit, si dhe nënshkrimin e përdoruesit.
6. Automjetet e KQZ-së, mund të përdoren për udhëtime zyrtare jashtë vendit. Zyrtari i SKQZ i drejtohet me kërkesë Drejtorit të Sekretariatit të KQZ-së për përdorimin e automjetit jashtë vendit (Shtojca II). Në rast të aprovimit, drejtori pajis me autorizim për përdorim të automjetit.

7. Nëse KQZ, nuk ka mundësi që udhëtimin zyrtar brenda dhe jashtë vendit, ta organizojë me automjete zyrtare, autorizon zyrtarin për shfrytëzimin e automjetit privat dhe bën kompensimin e shpenzimeve të derivateve sipas Rregullores së Brendshme Nr.10/2024 për Shtesat dhe Kompensimet në KQZ.
8. Çdo drejtues i automjetit zyrtar është i obliguar të plotësojë formularin e udhëtitimit, me të gjitha të dhënat relevante për atë udhëtim. Të dhënat në formular duhet të janë të sakta dhe të shkruara qartë. Formulari përmban: datën, emrin e drejtuesit të automjetit, emrin e pasagjerit, kohën e nisjes, kohën e arritjes, destinimin, tipin e veturës numrin e targave etj (Shtojca III dhe VII).
9. Nëse numri i kilometrazhit në fletudhëtim nuk përputhet me numrin e kilometrazhit në tabelën treguese në automjet, shfrytëzuesi i automjetit obligohet që ta informojë zyrtarin e transportit para se të fillojë ngasjen e automjetit.
10. Të gjithë personat që përdorin automjetet zyrtare janë përgjegjës për respektimin e rregullave të trafikut rrugor e në rast të kundërt bartin pasojat e pagesës së gjobës.
11. Përdoruesi i automjetit të KQZ, duhet të jetë i pajisur me patentë shofer të vlefshëm, të njojur nga autoritetet kompetente në Kosovë dhe autorizim për ngasjen e automjetit.
12. Automjetet e KQZ-së duhet të mbajnë shenjat identifikuese të KQZ dhe të kenë GPS.
13. Përdoruesi i automjetit të KQZ, është i obliguar që automjetin ta parkojnë në parkingun publik ose në ndonjë vend, ku zyrtari konsideron se automjeti është i sigurt.

**Neni 6**  
**Përdorimi i automjeteve nga Sekretariati jashtë orarit të punës**

1. Në rastet e caktuara, zyrtarëve të caktuar për shkak të specifikave jashtë orarit të punës, me aprovim të kërkesës nga Drejtori i Sekretariatit të KQZ-së, mund t'u lejohet përdorimi i automjeteve edhe jashtë orarit të punës. Me rastin e kërkesës duhet të paraqitet edhe arsyetimi i shfrytëzimit të automjetit.
2. Për shfrytëzimin e automjetit jashtë orarit të punës, duhet të njoftohet Zyrtari i Transportit.

**Neni 7**  
**Menaxhimi i automjeteve**

Zyrtari i transportit, është përgjegjës për menaxhimin e automjeteve në mënyrë efikase dhe efektive në: mbajtjen e çelësave, dërgimin e automjeteve në servisim, kontrollimin e

intervaleve dhe orarin për servisim të automjeteve në pajtim me udhëzimet e prodhuesit, përcjelljen e kilometrave dhe shpenzimeve të derivateve, kontrollimin e rregullt të pajisjeve të nevojshme për automjetet, përcjelljen e afateve të sigurimit dhe regjistrimit, pastrimin e veturës së paku një herë në javë dhe të gjitha përgjegjësitë e tjera, të cilat janë të natyrës së punës të Divizioni për administratë dhe shërbime të përbashkëta.

**Neni 8**  
**Shpenzimet e transportit privat për kryerjen e detyrave zyrtare**

1. Në rastet e arsyeshme dhe me qëllim të mbulimit të kërkesave për kryerjen e detyrave zyrtare atëherë kur nuk gjendet zgjidhje tjetër, mundësohet shfrytëzimi i automjetit privat që përfshin bartjen edhe të zyrtarëve tjerë pjesëmarrës në atë udhëtim zyrtar.
2. Në pamundësi të përdorimit të veturave zyrtare për anëtarët të KQZ, për kryerjen e punëve zyrtare gjatë 24 orëve brenda dhe jashtë vendit, KQZ mund të autorizoj përdorimin e veturave private, për të cilat:
  - 2.1.për udhëtimet brenda vendit sigurohet furnizimi me derivate tek operatori ekonomik i kontraktuar;
  - 2.2.për udhëtimet jashtë vendit sigurohet kompensimi 0.20 eruo, për kilometër, duke përzgjedhur destionacionin më të shkurtër të udhëtimit, në pajtim me Rregulloren Nr. 10/2024, për Shtesat dhe Kompensimet në KQZ.
3. Në pamundësi të përdorimit të veturave zyrtare të KQZ për zyrtaret e Sekretariatit të KQZ, për udhëtime zyrtare mund të përdoren veturat private. Kalkulimi i shpenzimeve për veturë private për vajtje-ardhje është 0.20 Euro për kilometër, duke përzgjedhur destionacionin më të shkurtër të udhëtimit, në pajtim me Rregulloren Nr.10/2024, për Shtesat dhe Kompensimet në KQZ.
4. Për rastet e kompensimit me 0.20 euro për kilometër llogaritën kilometrat e përcaktuara nga vendi i nisjes, deri në vendin ku kryhet detyra zyrtare dhe anasjelltas, e përcaktuar sipas platformës google map.
5. Kompensimi i shpenzimeve të lejuara për shfrytëzimin e veturave private për udhëtimet zyrtare bëhet përmes llogarisë bankare të zyrtarëve, pas përfundimit të udhëtimit zyrtar dhe paraqitjes së dokumentacionit përkatës.
6. Zyrtari finanziar në bazë të dokumentacionit përkatës merr veprimet e duhura për rimburësimin e shpenzimeve.

- Paraqitja e dokumentacionet dhe barazimet, duke përfshirë edhe avanset, atëherë kur janë shfrytëzuar, duhet të bëhet brenda pesëmbëdhjetë (15) ditë.

**Neni 9**  
**Përgjegjësia e vozitësit të automjetit**

- Përdoruesi i automjetit zyrtar duhet të zbatojë rregullat e përgjithshme të trafikut dhe është përgjegjës për shfrytëzimin e kujdeshëm të automjetit, si dhe përgjigjet për dëmin eventual të shkaktuar në automjetet me fajin e tij.
- Përdoruesi i automjetit zyrtar, në raste të ndonjë aksidenti që mund të shkaktohet gjatë kohës, kur ai është duke e drejtuar automjetin, shkaktuar me apo pa fajin e tij, duhet menjëherë të lajmërojë Policinë dhe të veprojnë në pajtim me Rregullat e bazuar në Ligjin për sigurinë në komunikacionin rrugor. Përdoruesi i automjetit duhet ta marr nga Policia raportin e aksidentit apo dëmtimit, pavarësisht se kush është përgjegjës për shkaktimin e aksidentit apo dëmtimit dhe pastaj ta njoftojë zyrtarin e transportit dhe t'ia dorëzojë raportet e policisë.
- Divizioni për administratë dhe shërbime të përbashkëta, brenda 24 orësh (apo varësisht si është e rregulluar me kontratë në mes të KQZ-së dhe kompanisë së sigurimeve), duhet që ta njoftojë për aksidentin kompaninë e sigurimeve të automjeteve të kontraktuar nga KQZ.
- Përdoruesi i automjetit, pjesëmarrësit e aksidentit të komunikacionit, në të cilën është shkaktuar një dëm më i vogël material në mjete, kanë për detyrë që menjëherë të mënjanojnë mjetet nga rruga, të mundësojnë zhvillim të papenguar të komunikacionit, të plotësojnë dhe të nënshkruajnë “Informacionin evropian” të aksidentit apo në ndonjë mënyrë tjetër të shkëmbejnë të dhënat personale dhe të dhënat për mjet.
- Zyrtari i transportit duhet të sigurohet që çdo automjeti i KQZ-së të jetë i pajisur me Raportin e Aksidentit të Trafikut (shtojca IV).
- Përdoruesi i automjetit, nuk duhet të lë vendin e aksidentit të komunikacionit derisa të mos e kenë plotësuar dhe nënshkruar “Informacionin evropian” apo në ndonjë mënyrë tjetër derisa ti shkëmbejnë të dhënat personale dhe të dhënat për automjetet.
- Personi i cili has në vendin e aksidentit të komunikacionit, në të cilën ka persona të lënduar, ka për detyrë t'u jap ndihmë personave të lënduar në aksident të komunikacionit dhe të njoftoj menjëherë institucionet shëndetësore dhe Shërbimin Policor të Kosovës, ose stacionin policor më të afërt.

8. Pjesëmarrësi në aksident të komunikacionit, në të cilën dikush ka humbur jetën ose është lënduar apo është krijuar një dëm i madh material, ka për detyrë:
  - 8.1.Të qëndroj në vendin e aksidentit të komunikacionit, por që mund të largohet përkohësisht vetë për t'u ofruar ndihmë personave të lënduar në aksident të komunikacionit apo në çoftë se vet atij i nevojitet ndihma mjekësore përkatësisht për ta njoftuar Shërbimin Policor të Kosovës;
  - 8.2.të ndërmarrë krejt çka mundet që të mënjanohen rreziqet e reja, që mund të krijohen në vendin e aksidentit të komunikacionit, të mundësohet një rrjedhë normale e komunikacionit, të bëhen përpjekje që të mos ndërrohet gjendja në vendin e aksidentit dhe të ruhen gjurmët ekzistuese, me kusht që ndërmarrja e atyre masave të mos rezikojë sigurinë e komunikacionit;
  - 8.3.të e njoftoj për aksidentin e komunikacionit Shërbimin Policor të Kosovës dhe të kthehet në vendin e aksidentit të komunikacionit dhe të pret ardhjen e personave të autorizuar, të cilët bëjnë ekzaminimin e vendit të aksidentit.
9. Zyrtari i transportit, duhet të evidentojë çdo dëmtim apo parregullsi që ka të bëjë me automjetin.
10. Përdorim i automjeteve zyrtare të KQZ-së në kundërshtim me rregullat e kësaj Rregullore ndëshkohen sipas përgjegjësisë materiale dhe disiplinore në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi.

#### **Neni 10** **Mirëmbajtja dhe servisimi i automjeteve të KQZ-së**

1. Përgjegjës për kontrollin, përdorimin, menaxhimin e automjeteve dhe zbatimin e kësaj Rregullore është Departamentit për financa dhe shërbime të përgjithshme pranë KQZ-së.
2. Divizioni për administratë dhe shërbime të përbashkëta ka për detyrë të bëjë kontroll ditor dhe periodik mbi automjetet dhe përdorimin e tyre.
3. Zyrtari i transportit obligohet të bëjë një kontroll vizuale mbi gjendjen e automjeteve para se të merret në shfrytëzim, si: presionin e gomave, vajin, ujin, nivelin e karburanteve, dritat, treguesit, etj.

4. Përdoruesi i automjetit, para se ta merr në shfrytëzim automjetin zyrtar të KQZ-së, bënë një kontolle vizuale të automjetit.
5. Automjeteve të KQZ-së duhet t'u bëhet servisimi i rregullt, në intervalt kohore të parapara nga prodhuesi.
6. Personeli i servisit të kontraktuar, pas kryerjes së servisimit të rregullt, e vendosin në automjet një etiketë me numrin e kilometrazhit për servisimin e radhës.
7. Para se të dërgohet automjeti për servisim të rregullt, duhet të plotësohet Formulari për servisimin e automjetit, (Shtojca V), i cili duhet të nënshkruhet nga Udhëheqësi i Divisionit për administratë dhe shërbime të përbashkëta, si dhe nga personi i servisit të kontraktuar kur automjeti dërgohet në servis.
8. Zyrtari i transportit, pasi të kthej automjetin nga servisi, duhet të kontrollon automjetin dhe ta nënshkruan raportin e kryerjes së punës së servisit të kontraktuar.
9. Zyrtari i transportit, nëse gjatë kontrollës ditore vëren se automjeti ka ndonjë defekt, atëherë pas plotësimit dhe nënshkrimit të formularit Raporti i Prishjes/Defektit dhe formularit Urdhëresë Pune, automjetin duhet ta dërgojnë për servisim/riparim në servisin e kontraktuar nga KQZ.
10. Zyrtari i KQZ-së, pas marrjes së automjetit në shfrytëzim, vëren se automjeti ka ndonjë defekt të dukshëm atëherë e lajmëron zyrtarin e transportit, të cilët kujdesen që automjeti të dërgohet për riparim.
11. Pasi të kthehet automjeti i riparuar nga servisi, zyrtari i transportit dhe menaxheri i kontratës duhet të kontrollon automjetin dhe ta nënshkruan raportin e kryerjes së punës së servisit të kontraktuar.
12. Zyrtari transportit, pas marrjes së automjetit të riparuar nga servisi i kontraktuar evidenton dhe fotografon pjesët e vjetra që i janë ndërruar automjetit dhe të njëjtat i paraqet në raportin e servisimit. Fotografitë ose dosja e evidentimit ruhen në dosjet përkatëse të automjeteve.
13. Formularët adekuat për mirëmbajtjen dhe servisimin e automjeteve të KQZ-së, duhet të përgatiten nga zyrtari i transportit.
14. Në rastet kur vetura prishet jashtë vendit, përdoruesi i automjetit njofton zyrtarin e transportit për tërheqjen e automjetit për vendet të cilat përfshihet tërheqja e automjetit në konratën për mirëmbajtjen dhe servisimin e automjeteve të e KQZ-së dhe KQZ mbulon:

- 14.1. shpenzimet e transportit nga destinacioni i servisimit deri në destinacionin zyrtar që udhëton dhe anasjelltas,
  - 14.2. shpenzimet e transportit nga vendi i akomodimit në lokacionin ku zhvillohet ngjarja,
  - 14.3. shpenzimet për lënien e veturës në parking të sigurt derisa të tërhiqet nga kompania përgjegjëse.
15. Në rastet kur vetura prishet jashtë vendit ku nuk është përfshirë tërheqja e automjetit në kontratën për mirëmbajtjen dhe servisimin e automjeteve të KQZ-së, përdoruesi i automjetit servisimin mund ta bëjë edhe në servisin jashtë vendit ku ka ndodhur prishja/dëmtimi.
  16. Pas servsimit të automjetit jashtë vendit, ku KQZ nuk ka kontrata për mirëmbajtjen dhe servisimin e automjeteve sipas paragrafit 15 të këtij neni, përdoruesi i automjetit duhet të sjellë si dëshmi: faturën e servisimit dhe përshkrimin e rastit të prishjes përmes një raporti të veçantë të përgatitur me shkrim prej tij,
  17. KQZ në rastet sipas paragrafit 16 të këtij neni mbalon për zyrtarin/zyrtarët të gjitha shpenzimet faktuara pas dëmtimit/prishjes së automjetit dhe të cilat mund të përfshijnë:
    - 17.1.bartjen e automjetit deri në vendin e servisimit,
    - 17.2.shpenzimet e transportit nga destinacioni i servisimit deri në destinacionin zyrtar që udhëton dhe anasjelltas,
    - 17.3.shpenzimet e transportit nga vendi i akomodimit në lokacionin ku zhvillohet ngjarja,
    - 17.4.shpenzimet tjera për tërheqjen e automjetit deri në selinë e KQZ në Prishtinë në rast të pamundësisë së rregullimit të automjetit në shëtitin ku ka ndodhur prishja/dëmtimi.

### **Neni 11 Raportimi**

1. Divizioni për administratë dhe shërbime të përbashkëta, të gjitha faturat e furnizimit me karburante, servisimit, larjes dhe shpenzimeve të tjera të automjeteve, brenda afatit të caktuar i procedon për pagesë.
2. Divizioni për administratë dhe shërbime të përbashkëta, harton raport tremujor për të gjitha shpenzimet e automjeteve. Raportin mujor për sasinë e karburanteve të shpenzuara (Shtojca VI) dhe i njëjtë raport kontrollohet nga Drejtori i Departamentit për financa dhe shërbime të përgjithshëm dhe procedohet për shqyrtim në Këshillin për Buxhet dhe Financa dhe pastaj për miratim në KQZ.

**Neni 12**  
**Dispozitat përfundimtare**

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohet Udhëzimin Administrativ KQZ/04/2015, Mbi Mënyrën e Përdorimit të Automjeteve Zyrtare të KQZ-së dhe Mirëmbajtja e Tyre, i miratuar më 23.12.2015.
2. Pjesë përbërëse të kësaj Rregullore janë shtojcat:

1. Shtojca I - Kërkesa për përdorim të veturave brenda vendit
2. Shtojca II - Kërkesa për përdorim të veturave jashtë vendit
3. Shtojca III – Formulari i udhëtimit për SKQZ
4. Shtojca IV- Raporti i aksidentit të trafikut
5. Shtojca V - Formulari për servisimin e automjetit
6. Shtojca VI - Sasia e kilometrave të shpenzuara në muaj
7. Shtojca VII - Formulari i udhëtimit për KQZ

**Neni 13**  
**Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.





Shtojca nr. I

## KËRKESA PËR UDHËTIM ZYRTAR BREND A KOSOVËS

Institucioni	
Departamenti/Divizioni	
Emri dhe mbiemri i Zyrtarit	
Pozita e punës e Zyrtarit	

ZYRTARËT QË UDHËTOJNË:


PËRSHKRIMI I UDHËTIMIT DATA: \_\_\_\_\_

PREJ: \_\_\_\_\_ NË: \_\_\_\_\_

KOHA E NISJES: 00:00: KOHA E KTHIMIT: 00:00

ARSYETIMI I UDHËTIMIT :

AUTORIZUAR NGA UDHËHEQËSI MË I LARTË ADMINISTRATIV I INSTITUCIONIT

Emri dhe mbiemri:

Pozita:

Data:

Nënshkrimi: \_\_\_\_\_

Vërejtje: Formulari plotësohet nga zyrtari i cili udhëton dhe dorëzohet për miratim të Drejtori i Sekretariatit të KQZ një ditë para udhëtimit.



Shtojca nr. II

Republika e Kosovës  
Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission



## KËRKESË PËR PËRDORIM TË PËRKOHSHËM TË VETURAVE JASHTË VENDIT

Emri dhe mbiemri: \_\_\_\_\_ Nr. ID: \_\_\_\_\_ Titulli: \_\_\_\_\_  
(zyrtari kërkues)

Departamenti: \_\_\_\_\_ Sektori: \_\_\_\_\_ Nr. i tel: \_\_\_\_\_

Data e kërkesës prej: \_\_\_\_\_ Koha: \_\_\_\_\_ Deri: \_\_\_\_\_ Koha: \_\_\_\_\_

Arsyeja e kërkesës: \_\_\_\_\_

Lloji i automjetit: \_\_\_\_\_ Nr. i pasagjerëve \_\_\_\_\_ Bagazhi: \_\_\_\_\_

Emri i vozitësit: \_\_\_\_\_ Nr. I ID: \_\_\_\_\_ Nr. serik i autorizimit: \_\_\_\_\_

Autorizuar nga Drejtori i Departamentit: \_\_\_\_\_  
(Emri) \_\_\_\_\_ (nënshkrimi) \_\_\_\_\_

Automjeti është pranuar në gjendje të rregullt. Veglat dhe rrota rezervë në rregull, pa dëme të dalluara.

Vërejtjet: \_\_\_\_\_

### Shënimë të rëndësishme:

Mjeti të kthehet i pastër dhe i mbushur me derivate në afatin kohor të cekur. Çfarëdo dëmi, mos përputhje në automjet duhet të raportohet menjëherë dhe të registrohet në fletën e udhëtimit.

Shënuar nga: \_\_\_\_\_  
(Emri) \_\_\_\_\_ (nënshkrimi) \_\_\_\_\_ (Nr. i ID.) \_\_\_\_\_ (data)

## VETËM PËR NJËSINË E TRANSPORTIT

Nr. i targave të automjetit: \_\_\_\_\_ Autorizuar nga: \_\_\_\_\_  
(zyrtari i transportit)

Data e dorëzimit: \_\_\_\_\_ Koha: \_\_\_\_\_ Nr. i km në fillim: \_\_\_\_\_

Data e kthimit: \_\_\_\_\_ Koha: \_\_\_\_\_ Nr. i km. në fund: \_\_\_\_\_

Gjithsej numri i kilometrave të kaluara: \_\_\_\_\_  
Automjeti i kthyer në gjendje të rregullt. Veglat dhe rrota rezervë në rregull dhe pa dëme të dalluara  
Vërejtjet: \_\_\_\_\_

(nënshkrimi i zyrtarit të transportit) \_\_\_\_\_ (nr. i ID.) \_\_\_\_\_ (data)



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
*Komisioni Qendror i Zgjedhjeve*  
*Centralna Izborna Komisija*  
*Central Election Commission*



## Shtojca nr. IV



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
*Komisioni Qendror i Zgjedhjeve*  
*Centralna Izborna Komisija*  
*Central Election Commission*



### **INSTRUKCIONET PER MBUSHJEN E RAPORTIT TË AKSIDENTIT TË TRAFIKUT**

1. RAPORTI I AKSIDENTIT TË TRAFIKUT TË MBUSHET NË VENDIN E NGJARJES.
2. TË SHTYPET NË MËNYRË TË PASTËR.
3. TË JESH I SAKT, TË PLOTËSOHEN TË GJITHA ZBRASËSIRAT NËSE DISA INFORMATATA NUK JANË TË DHËNA NË ATË VEND TË PRINTOHET FJALA E PADITUR.
4. TË JESH I SAKTË RRETH LOKACIONIT. TË PËRDOR DISTANCAT NGA SHENJAT TOKËSORE TË PËRHershme DHE /OSE NDËRPRERJET E RRUGËS PËR TË VENDOS SKENËN E AKSIDENTIT.NËSE REFERENCA E RRJERIT KOORDINATIV ËSHTË E NJOHUR, SHTYPE ATË NË PJESËN E FORMËS TË CILËN DO TA MBASH.
5. AKSIDENTI DUHET TË RAPORTOHET TEK AUTORITETET POLICORE.
6. AUTOMJETI, DUHET TË VOZITET, TË PËRMIRËSOHET TEK SERVISI MË I AFËRT, KU DËMET E AUTOMJETIT DO TË MBIKQYREN NGA NJËSIA E RAPORTEVE TË DËMEVE DHE MOSPËRPUTHJEVE. NJË KOPJE E RAPORTIT TË AKSIDENTIT, ME VULË TË SIGURIMIT DUHET QË TI IPET KËSAJ NJËSIE.

## Shtojea nr. IV

# Raporti i Aksidentit për drejtuesit e automjeteve zyrtare

Të kompletohet nga drejtuesit e automjeteve

Data: \_\_\_\_\_

Nr. i Referencës së Rastit: \_\_\_\_\_

### Shënimet e drejtuesit te automjetit zyrtare:

Emri: \_\_\_\_\_

Ngarkim funksioni: \_\_\_\_\_

Nr. i ID: \_\_\_\_\_

Nacionaliteti: \_\_\_\_\_

Targat e Auto. zyrtare: \_\_\_\_\_

Nr. i patën shoferit: \_\_\_\_\_

Tipi i Auto. Zyrta: \_\_\_\_\_

Fund i detyrës: \_\_\_\_\_

Viti i Auto: \_\_\_\_\_

Llog. E shpejtësisë: \_\_\_\_\_

Departamenti: \_\_\_\_\_

Sektori/Divizioni: \_\_\_\_\_

Rripi sigurues i ngjitur: \_\_\_\_\_

Nr.i Tel: \_\_\_\_\_

Dëmet: \_\_\_\_\_

Lokacioni i zyrës: \_\_\_\_\_

Lëndimet: \_\_\_\_\_

Mjeku/ Spitali: \_\_\_\_\_

Udhëtarët: \_\_\_\_\_

Nr. serik i autorizimit: \_\_\_\_\_

### **Shënimet e palës tjetër:**

Emri: \_\_\_\_\_

Kompa. e Sigurimeve: \_\_\_\_\_

Adresa: \_\_\_\_\_

Polica e sigurimit: \_\_\_\_\_

Nr. i tel: \_\_\_\_\_

Pronari: \_\_\_\_\_

Nr. i patentë shoferit: \_\_\_\_\_

Adresa: \_\_\_\_\_

Tipi i veturës: \_\_\_\_\_

Dëmet: \_\_\_\_\_

Targat e veturës: \_\_\_\_\_

Mjeku/ Spitali: \_\_\_\_\_

Udhëtarët: \_\_\_\_\_

Lëndimet: \_\_\_\_\_

### **Raporti i Aksidentit:**

Data e aksidentit: \_\_\_\_\_

Koha: \_\_\_\_\_

Komuna ku ka ndodhur aksidenti: \_\_\_\_\_

Lokacioni: \_\_\_\_\_

Raportuar ne stacionin policor ne: \_\_\_\_\_

Nr. i tel. te stacionit policor: \_\_\_\_\_

Emri zyrtarit policor: \_\_\_\_\_

Nr. i ID. se zyrtarit policor: \_\_\_\_\_

Informat Relevant: \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

KONFIGURACIONI 1-DREJTË 2-KTHESË 3-KRYQEZIM-T 4-KRYQEZIM-Y 5-UDHEKRYQ 6-ITERTHORTË 7-RRUGË NGUSHËTË 8- KALIM NË NIVEL 9- TË TJERË	SIPERAFAQJA E RRUGËS 1-BETON 2-PISTË E ASHPËR 3-PISTË E BUTË 4-THNGJILL 5-BLOK DRURI 6-TOKË/RËRË 7-TJERA (SPECIFIKO)	MOTI 1-EKTHJELLËTË 2-MJEGULL OSE VESË 3-SHI OSE BRESHËR 4-BORË APO BORË PËRZIER ME SHI 5-TYM OSE PLUHUR 6-ERË E FORTË 7- TJERA (SPECIFIKO)	GJENDJA E RRUGËS 1-E THATË 2-E LAGUR 3-E NGRIRË 4-ME BALTË 5-E SHTRUAR ME RËRË 6-E SHTRUAR ME BAR 7- TJERA (SPECIFIKO)	NDRIQIMIT RRUGËS 1-ESHËNDRIT SHME 2-E HAUPUR 3-E TRUBULLT 4- PA DRITË/E ERRËT 5- TJERA (SPECIFIKO)	TRAFIKU 1-NUK KA 2-I VOGËL 3-MESTAR 4-IDENDUR 5-TJERA (SPECIFIKO)
---	--	--	---	--	--

SHKALLËZIMI I RRUGËS 1- DREJT 2-JERRTËSI E DREJTË 3-ERPJETËSE E THIKTË 4-REG I LAFSHTË 5-URA 6-TJERA SPECIFIKO)	TIPI I RRUGËS 1-RRUGË NJËKAHËSHE 2-RRUGË DYKAHËSHE 3-RRUGË TRANSPORTUESE 4-AUTOSTRADË 5-JERA (SPECIFIKO)	PERIUDHA DITORE 1-AGIM 2-MESDITË 3-MUZGU 4-NATA 5- TJERA (SPECIFIKO)	SHENJAT E TRAFIKUT 1-SEMAFOR 2-SHENJË NDALIMI/STOP 3-SHENJË NGADALSIMI 4-SHENJË PËRPARËSJE KUFIZIME TË TJERA 6- TJERA (SPECIFIKO)	DUKSHMËRIA 1-DERI MË 25 m. 2-DERI MË 50 m. 3-DERI MË 75m. 4-DERI MË 100 m. 5- MË SHUMË SE 100m 6-JERA (SPECIFIKO)	SHENJAT E POSAÇME 1-PUNË NË RRUGË 2-SHPEJTËSI E KUFIZUAR 3-INJË TRAMVAJI 4-PARKING ILEGAL 5-VENDKALIM 6-TJERA (SPECIFIKO)
--	---	---	--	---	--

Lloji aksidentit			
1. PËRPLAS JE ME KOKË		17. DALJA NGA RRUGA DHE RUTULLIM	
2. GJËNDRA E QAFËS- AUTO. NË DREJTIM TË NJEJTË		18. DALJA NGA RUGA PA RUTULLIM	
3. GJËNDRA E QAFËS- AUTO. NË DREJTIM TË KUNDËRT		19. RUTULLIM (PA AKSIDENT)	
4. GJËNDRA E QAFËS –DUKE KTHYER DJATHTAS		20. NJË PJSË E VETURËS U SHKËPUT	
5. GJËNDRA E QAFËS-DUKE KTHYER MAJTAS		21. NJË PJSË E NGARKESËS U SHKËPUT	
6. AKSIDENTI I ANËS SË DJATHË NGA VETURA NË TË MAJTË		22. ZJARI	
7. AKSIDENTI I ANËS SË MAJTË NGA VETURA NË TË DJATHË		23. GODITJA NGA FLUTURIMET /OBJEKTE FLUTURUESE	
8. GODITJA E VETURËS TJETËR NGA MBRAPA NË TRAFIK		24. GODITJA E QIKLISTËVE	
9. GODITJA MBRAPA NGA VETURA TJETËR NË TRAFIK		25. GODITJA E KËMBËSORËVE	
10. GODITJA E VETURËS TJETËR DUKE VOZITUR MBRAPA NË TRAFIK		26. GODITJA E KAFSHËVE	
11. GODITJA NGA VETURA TJETËR DUKE VOZITUR MBRAPA NË TRAF.		27. RIMORKIO U SHKËPUT	
12. GODITJA E OBJEKTEVE STATIKE NË VOZITJE TË PËRPARME		28. PERMJA ME THIKË E RIMORKIO	
13. GODITJA E AUTO. E PARKUAR DUKE VOZITUR PËRPARA		29. AKSIDENT ME RËZIMIN E AEROPLANIT	
14. GODITJA E VETURËS SË PARKUAR NË VOZITJE PRAPA		30. DËMTIM NË RETHANA TË PA NJOHURA	
15. GODITJA E VETURËS SË PARKUAR NË VOZITJE PRAPA		31. PARAKALIM	
16. I GODITUR -I PARKUAR NGA VETURA TJETËR		32. AKSDENTE TJERA(CILËSOJE TIPIN)	

## PËRSHKRIMI I DETALEVE (POASHTU VEPRIMET E MARA DHE NË DETALE TË SKICUARA)

(VAZHDO NË FAQEN REZERVE SIMBAS NEVOJËS)

**VËREJTE:** TË GJITHA AKSIDENTET DUKE PËRFSHIR LENDIMET DHE DËMTIME T MATERIALE DUHET MENJËHER TË RAPORTOHEN NE NJESINE E TRANSPORTIT.  
MBAS PLOTESIMIT DHE NENSHKRIMIT TE RAPORTIT TE AKSIDENTIT MBRENDA 48 OREV E MBAS AKSIDENTIT DUHET T'I DOREZOHEZ NJESISE SE TRANSPORTIT.

Emri i drejtuesit te automjetit zyrtar: \_\_\_\_\_ Data: \_\_\_\_\_ Ora: \_\_\_\_\_



Shtoja nr. V

## URDHËR PUNE

Data :

Numri i urdhrit të punës  
UP \_\_\_\_\_ /S/

Për :

Kompania :  
Adresa :  
Telefoni:  
Fax:  
E-mail:  
Personi

Menagjeri i Autoservisit

kontaktaues :

PREJ:

Njësia:  
Sektori:  
Departamenti:  
Telefoni:

Personi

kontaktaues :

### Përshkrimi i veturës

Numri i regjistrimit : \_\_\_\_\_  
Tipi i veturës : \_\_\_\_\_

Km. E lexuara : \_\_\_\_\_ Kms  
Servisi tjetër në : \_\_\_\_\_ Kms

Nr.	Përshkrimi (Përshkruaj specifikacionet për servisim, riparim apo ndonjë punë tjetër)	Vërejtje
1		
2		
3		
4		
5		
6		
7		
8		
9		
10		
11		
12		

Data e kërkesës:

Data kur puna duhet  
të kompletohet

Referencat për pages:

Nënshkrimi i  
Autorizuesit :

Emri:

Numri i kartelës :

### HAPËSIRA PËR AUTOSERVIS



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Komisioni Qendror i Zgjedhjeve*  
*Centralna Izborna Komisija*  
*Central Election Commission*



Sasia e karburanteve të shpenzuara përmuanin

## Shtoječa nr.VI

Vereitie me rendesi:

- a) eshtë përgjegjësi e shoferit ta kontrolloj automjetin për prishje.
  - b) të gjitha aksidentet dhe incidentet me automjetin zyrtarë duhet të raportohen te zyrtari i transportit brenda 24 orëve.
  - c) fletë udhëtimi i automjetit zyrtarë duhet t'i dorëzohet zyrtarit të transportit qiatë parë të cdo muai.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republika of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission

